



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.33

2005

18 maj

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.182, datë 21.4.2005	Për zgjedhjen e zotit Adrian Civici anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë	1219
Vendim i Kuvendit nr.183, datë 28.4.2005	Për miratimin e metodikës për vlerësimin e pronës së paluajtshme që kompensohet dhe asaj që do të shërbejë për kompensim	1219
Vendim i Kuvendit nr.184, datë 28.4.2005	Për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar për Taksën e Rrugës Durrës-Kukës.....	1226
	Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2004	1226
	Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për vitin 2004.....	1227
Vendim i KM nr.267, datë 28.4.2005	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, për shpenzimet e kryera për përballimin e emergjencave nga reshjet e borës.....	1228
Vendim i KM nr.268, datë 28.4.2005	Për përcaktimin e kufijve maksimalë të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve, për mbulimin e provigjoneve teknike dhe	

	matematike, nga shoqëritë e sigurimeve.....	1228
Vendim i KM nr.269, datë 28.4.2005	Për kriteret dhe masën e mbulimit financiar të kujdesit shëndetësor për ushtarakun e Forcave të Armatosura	1231
Vendim i KM nr.270, datë 15.4.2005	Për miratimin e projektkontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime “Armo”.....	1232
Vendim i KM nr.272, datë 28.4.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	1246
Vendim i KM nr.279, datë 28.4.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.313, datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës”.....	1246
Vendim i KM nr.280, datë 21.4.2005	Për miratimin e marrëveshjes së aksionarëve të Bankës Italo-Shqiptare	1247
Vendim i KM nr.281, datë 28.4.2005	Për dhënien në administrim të përkohshëm Albpetrol sh.a.-së, Patos, të një sipërfaqeje toke, të nevojshme për shpimin dhe vënien në shfrytëzim të pusit Delvina-34	1247
Vendim i KM nr.282, datë 28.4.2005	Për miratimin e protokollit të sesionit të 8-të të komisionit të përbashkët shqiptaro-turk, për bashkëpunimin ekonomik, tregtar, industrial dhe teknik.....	1248
Vendim i KM nr.283, datë 28.4.2005	Për fillimin e procedurave për dhënien me koncesion të objektit “Shërbimi i lavanderisë dhe i pastrimit të brendshëm në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik nr.1 e nr.2, Tiranë, dhe në Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive, Tiranë”.....	1254
Vendim i KM nr.285, datë 28.4.2005	Për lejimin e daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për qëllime restaurimi, të pikturës “Motra Tone”, objekt me vlera unike të trashëgimisë kulturore kombëtare.....	1254
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Cuman Vrako.....	1255

VENDIM
Nr.182, datë 21.4.2005

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ADRIAN CIVICI ANËTAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 44 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Adrian Civici zgjidhet në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në vend të zotit Andis Harasani, i cili ka dhënë dorëheqjen.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.183, datë 28.4.2005

**PËR MIRATIMIN E METODIKËS PËR VLERËSIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME QË
KOMPENSOHET DHE ASAJ QË DO TË SHËRBEJË PËR KOMPENSIM**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 13 pika 2 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, me propozimin e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i metodikës për vlerësimin e pronës së paluajtshme.
2. Me vlerë të tokës bujqësore, pyjore, pyjeve, livadheve, kullotave, truallit dhe truallit në zonat turistike kuptohet vlera e pronës që kompensohet dhe asaj që do të shërbejë për kompensim, sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

Neni 2
**Vlera e tokës bujqësore, pyjore, pyjeve, livadheve, kullotave
dhe tokave të zëna nga liqenet e hidrocentraleve dhe rezervuarëve të ujitjes**

1. Vlera e tokës bujqësore përcaktohet nga këto kritere:
 - a) kategoria e tokës bujqësore;
 - b) struktura e mbjelljeve;
 - c) rendimenti i kulturave bujqësore;
 - ç) vlerësimi i fitimit neto për njësi të tokës bujqësore;
 - d) çmimi potencial i tokës, sipas kapitalizimit të vlerës së fitimit neto.
2. Vlera potenciale e tokës bujqësore, e llogaritur sipas kritereve të pikës 1 të këtij neni, korrektohet me koeficientët e mëposhtëm:
 - a) koeficienti i ujitjes;
 - b) koeficienti për distancën nga qendrat urbane dhe industrinë përpunuese;
 - c) koeficienti i zhvillimit;
 - ç) koeficienti i shfrytëzimit të tokës.
3. a) Tokat pyjore vlerësohen me të njëjtën metodë që do të zbatohet për tokat bujqësore;
- b) vlera e livadheve dhe e kullotave është ekuivalente me vlerat e llogaritura të tokave bujqësore të grupimit të pestë;
- c) vlera e pyllit prodhues përcaktohet sipas 5 klasave të prodhimit, ku do të meren në konsideratë volumi drusor dhe cilësitë e tokës nën pyll.
4. Vlera e tokave të zëna nga liqenet e hidrocentraleve dhe rezervuarët e ujitjes llogaritet si mesatare aritmetike e vlerës së tokave, që ndodhen në brigjet e baseneve ujore respektive.

Neni 3

Vlera e truallit dhe e ndërtesave

1. Vlerësimi i truallit bazohet në këto kritere:
 - a) raporti i sipërfaqes së ndërtimit me sipërfaqen e truallit;
 - b) pjesa takuese e ndërtimit që merr pronari i truallit;
 - c) çmimi mesatar i shitjes së banesave.
2. Vlera e truallit, e llogaritur sipas kritereve të pikës 1 të këtij neni, korrektohet me koeficientët e mëposhtëm:
 - a) koeficienti që merr parasysh ndikimin e kateve nëntokësore;
 - b) koeficienti që merr parasysh ndikimin e kateve me funksion tregtar.
3. Vlera e ndërtesave bazohet në këto kritere:
 - a) vlerën e investimit;
 - b) vlerën e amortizimit.
4. Formulatat e përlllogaritjes së vlerës së truallit dhe ndërtesave përcaktohen sipas aneksit 2 bashkëngjitur këtij vendimi.

Neni 4

Vlera e truallit në zonat turistike

1. Vlera e truallit në zonat turistike llogaritet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - çmimi i poshtëm i mesatarizuar i truallit në zonën bregdetare, liqenore dhe kontinentale.
2. Vlera e truallit në zonën turistike, e llogaritur sipas kritereve të pikës 1 të këtij neni, korrektohet me koeficientët e mëposhtëm:
 - a) koeficienti i urbanizimit;
 - b) koeficienti i zonimit;
 - c) koeficienti i infrastrukturës;
 - ç) koeficienti i zhvillimit.
3. Formula e përlllogaritjes së vlerës së truallit në zonën turistike përcaktohet sipas aneksit 3 bashkëngjitur këtij vendimi.

Neni 5

Harta e vlerës së pronës

1. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në bashkëpunim me institucionet shkencore, përgatit hartën e vlerës së pronave, sipas kësaj metodike.

2. Këshilli i Ministrave, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të planifikojë fondet dhe mjetet e nevojshme për realizimin e tij.

Neni 6

Udhëzimi për detajimin e kriterëve të vlerësimit dhe koeficientëve të korrektimit

Burimi i të dhënave për vlerësimin e pronës, sipas metodikës, të merret nga dokumentet zyrtare të Republikës, sipas aneksit 4 bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

ANEKSI 1

PËRCAKTIMI I VLERËS SË TOKËS BUJQËSORE, TOKAVE PYJORE, PYJEVE, LIVADHEVE, KULLOTAVE DHE TOKAVE TË ZËNA NGA LIQENET E HIDROCENTRALEVE APO REZERVUARËT E UJITJES

I. Tokat bujqësore

Për përcaktimin e vlerës së tokave bujqësore do të kihet parasysh etapat e mëposhtme:

I.1. Përcaktimi i strukturës së mbjelljeve (burim referues: 1.1).

Për këtë qëllim do të përdoret vjetari statistikor i botuar nga Ministria e Buqësisë dhe Ushqimit, sipas rretheve. Për përcaktimin e strukturës do të merren në konsideratë kulturat bujqësore që zënë deri 0,5% të sipërfaqes. Kulturat me përqindje më të vogël do të eliminohen.

I.2. Vlerësimi i prodhimit (burim referues: 1.2).

Në esencë të vlerësimit të rendimentit qëndron lidhja që ekziston ndërmjet prodhueshmërisë, cilësive të brendshme dhe faktorëve të jashtëm të një toke. Tokat, sipas cilësive të tyre të brendshme, cilësi që kushtëzojnë prodhimin, kategorizohen në 5 grupe.

I.3. Vlerësimi i fitimit neto në njësi të tokës bujqësore (burimi referues: 1.1).

Duke pasur të llogaritur strukturën për tërësinë e kulturave të tokës bujqësore për 1 ha, si dhe rendimentin e siguruar për çdo kulturë, llogariten të ardhurat (prodhimi x çmimi e tregut), shpenzimet dhe fitimi neto (të ardhurat – shpenzimet = fitimi neto).

I.4. Llogaritja e çmimit potencial për toka të grupit të parë (burimi referues: 1.4).

Konsiston në logjikën ekonomike, sipas së cilës një ish-pronari i duhet të sigurojë një çmim të tillë shitjeje të tokës së tij që, duke e depozituar në bankë, të mund të përfitojë një interes vjetor të barabartë me fitimin neto që do të siguronte toka duke e kultivuar atë. Në këtë rast do të përdoret formula 1.

Çmimi potencial i tokës = $(100 * \text{fitimi neto}) / \% \text{ e interesit bankar}$

Form. 1

I.5. Llogaritja e çmimit për tokat e grupeve të tjera (burimi referues: 1.5).

Për tokat e kategorive nga e dyta në të pestën do të përdoren përqindjet reduktuese të potencialiteteve agronomike si më poshtë:

Grupi I Irë → Grupi I IItë = reduktohet me 17% (ose * 0,83)

Grupi I Irë → Grupi I IIItë = reduktohet me 35% (ose * 0,65)

Grupi I Irë → Grupi I IVtë = reduktohet me 53% (ose * 0,47)

Grupi i Irë → Grupi i Vtë = reduktohet me 72% (ose * 0,28)

Koeficientët e korrektimit

1. Koeficienti i ujitjes (burimi referues: 1.6).

Koeficientët e ndikimit të faktorit ujë, sipas kategorive të tokës, llogariten si më poshtë:

Grupimi i parë = 0,6

Grupimi i dytë = 0,7

Grupimi i tretë = 0,8

Grupimi i katërt = 0,9

Grupimi i pestë = 0,9

2. Koeficientët për distancën nga qendrat urbane, industritë përpunuese (burimi referues 1.7).

Për tokat e vendosura deri në 10 km nga qendrat urbane dhe industriale = 1,000.

Për tokat e vendosura nga 10 deri në 20 km nga qendrat urbane dhe industriale = 0,985.

Për tokat e vendosura nga 20 deri në 30 km nga qendrat urbane dhe industriale = 0,970.

Për tokat e vendosura mbi 30 km nga qendrat urbane dhe industriale = 0,930.

3. Koeficienti i zhvillimit (burimi referues: 1.8).

Rajoni i parë : Qarku Durrës, Fier, Vlorë, Tiranë, me koeficient = 1,00

Rajoni i dytë : Qarku Shkodër, Lezhë, Berat, Gjirokastër, me koeficient = 0,97

Rajoni i tretë : Qarku Korçë, Elbasan, me koeficient = 0,95

Rajoni i katërt: Qarku Dibër, Kukës, me koeficient = 0,93

4. Koeficienti i shfrytëzimit të tokës (burimi referues: 1.9).

Nga analiza e sipërfaqeve të mbjella (Vjetari Statistikor i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit) rezulton se koeficienti i shfrytëzimit të tokës varion nga 1,25 për zonën bregdetare në 1,15 për zonat kodrinore të ujtitshme dhe 1,05 për zonat malore. Për pasojë, fitimi i realizuar në këto sipërfaqe duhet të shumëzohet me koeficientët e mësipërm.

II. Tokat pyjore, livadhet, kullotat dhe pyjet

Tokat pyjore do të vlerësohen me të njëjtën metodë që do të zbatohet për tokat bujqësore.

Vlera e livadheve dhe e kullotave do të jetë ekuivalente me vlerat e llogaritura të tokave bujqësore të grupimit të pestë, ndërsa vlera e pyllit prodhues do të përcaktohet sipas 5 klasave të prodhimit ku do të merren në konsideratë volumi drusor dhe cilësitë e tokës nën pyll.

III. Tokat e zëna nga liqenet e hidrocentraleve dhe rezervuarët e ujitjes

Vlera e këtyre tokave do të llogaritet si mesatare aritmetike e çmimeve të tokave që ndodhen në brigjet e baseneve ujore respektive (liqene ose rezervuarë ujitës).

ANEKSI 2

PËRCAKTIMI I VLERËS SË TRUALLIT DHE NDËRTESAVE

1. Trualli brenda vijave të verdha

Vlerësimi i këtyre trojeve do të bëhet sipas formulës 2.

$Vt = K \times P \times \text{Çm}$

Form. 2

Ku:

Vt: vlera e truallit për ndërtim;

K: koeficienti i ndërtimit;

P: përqindja që marrin pronarët e truallit;

Çm: çmimet mesatare të shitjes së banesave.

$K = 1,2 \div 1,8 \text{ m}^2 \text{ ndërtim/m}^2 \text{ truall për një shfrytëzim të truallit deri në 50\% dhe } K = 2,5 \text{ m}^2 \text{ ndërtim/m}^2 \text{ truall për zonat e qendrës ku lejohet një shfrytëzim i truallit deri 75\%.$

$P = 15 \div 35\%$.

Në rastet kur merren në vlerësim edhe faktorë të tjerë, si katet nëntokësore, mjediset tregtare ose efekti i jonjëkohshmërisë së vlerësimit me marrjen e produktit nga trualli, Vt do të përcaktohet sipas formulës 3.

$Vt = K \times P \times \text{Çm} \times K_{pa} \times K_{tr} \times K_l$

Form. 3

Ku:

K_{pa} : Koeficient i cili merr parasysh ndikimin e kateve nëntokësore (parking). Vlera e këtij koeficienti varion nga 1,1 në 1,05. Vlera më e madhe do t'i takojë koeficientit më të vogël të ndërtimit. Në rast se nuk do të kemi ndërtime me kate nëntokësore (Durrësi, Vlora, Pogradeci etj.), vlera e këtij

koeficienti do të merret 1.

Ktr: Koeficient i cili merr parasysh ndikimin e kateve me funksion tregtar (dyqane në katin përdhe). Vlera e këtij koeficienti varion nga 1,2 në 1,1. Vlera më e madhe do t'i takojë koeficientit më të vogël të ndërtimit.

K1: Koeficient zvogëlues që merr në konsideratë mospërputhjen në kohë të vlerësimit të pronës dhe marrjes së produktit nga pronari. Ky koeficient varjon nga 1 për zonat periferike në 0,8 për zonat e qendrës së qyteteve.

Vlera e tokave që ndodhen në zonën suburbane do të variojë nga 0,2 deri në 0,5 të vlerës së zonës truall më të afërt, brenda vijës së verdhë.

2. Trojet në qytetet dhe komunat ku investimet nuk janë rentabël

$$Vt = K \times P \times \text{Çme}$$

Form. 4

Vlerat e P variojnë nga 5 në 15% dhe Ç me do të merret i barabartë me çmimet e Entit Kombëtar të Banesave dhe K është koeficienti i ndërtimit.

3. Trojet industriale

Vlera e këtyre trojeve përcaktohet sipas formulës 5.

$$Vti = Vt \times K1 \times Kn/K$$

Form. 5

Ku :

Vti: vlera e truallit industrial.

Vt: vlera e tokës e përcaktuar si truall më i afërt me tokën industriale që do të vlerësojmë.

K1: koeficienti i ndërtimit të zonës industriale që vlerësohet. Ky koeficient përcaktohet nga gjendja faktike e zonës industriale.

Kn: koeficienti i ndotjes industriale. Vlera e këtij koeficienti lëviz nga 0,4 deri në 1, sipas nivelit të ndotjes.

K: koeficienti i ndërtueshmërisë së zonës më të afërt me atë industriale.

4. Zonat suburbane

Vlera e tokës që ndodhet në zonën suburbane do të variojë nga 0,5 në 0,2 të vlerës së truallit më të afërt, brenda vijës së verdhë.

5. Ndërtesat

Në këtë rast vlera e godinës përcaktohet nga ana e ekspertëve të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sipas formulës së mëposhtme:

Ku:

$$Vnd = Vi - Am$$

Form. 6

Vnd: vlera e ndërtesës;

Vi: vlera e investimit;

Am: vlera e amortizimit në vite e objektit.

ANEKSI 3

PËRCAKTIMI I VLERËS SË TRUALLIT NË ZONAT TURISTIKE

Kthimi dhe kompensimi fizik i pronave brenda zonave turistike kryhet vetëm në përputhje me studimet urbanistike të miratuara.

1. Vlera e truallit në zonë turistike

$$Vt = \text{Ç} \times Ku$$

Form. 7

Ku:

Vt: vlera e truallit në zonë turistike;

Ç: çmimi i poshtëm i mesatarizuar i shitjes së truallit do të merret:

a) Për zonat turistike bregdetare dhe liqenore: $\text{Ç} = 40 \text{ EUR/m}^2$,

b) Për zonat turistike kontinentale: $\text{Ç} = 20 \text{ EUR/m}^2$

Koeficienti i urbanizimit (Ku) është rezultat i prodhimit të disa koeficientëve, të cilët marrin në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- largësinë e sipërfaqes për kompensim nga vija e bregut;
 - furnizimin ose jo të sipërfaqes për kompensim me infrastrukturë;
 - destinacionin e zhvillimit.
- Si rezultat koeficienti urbanizimit do të marrë formën e mëposhtme:

$$K_u = K_z \times K_i \times K_{zh}$$

Form. 8

Ku:

Kz: koeficienti i zonimit;

Ki: koeficienti i infrastrukturës;

Kzh: koeficienti i zhvillimit.

1. Koeficienti i zonimit (Kz)

a) Për zonat në bregdet dhe liqene:

	Adriatik	Jon	Liqene	Kz
Distanca nga bregu	800 – VKSU*	600 - VKSU	400 - VKSU	1,0
	500 - 800	400 - 600	200 - 400	1,4
	Deri në 500	Deri në 400	Deri në 200	1,8

b) Për zonat kontinentale

Distanca nga qendra e zonës	Kz
600 – VKSU*	1,0
400 – 600	1,2
Deri në 400	1,4

*VKSU: vija kufizuese e studimit urbanistik

Diapazoni i Koeficientit të Zonimit (Kz) për zonat bregdetare dhe liqenore: 1,0 – 1,8

Diapazoni i Koeficientit të Zonimit (Kz) për zonat kontinentale: 1,0 - 1,4

2. Koeficienti i infrastrukturës (Ki)

Kur zona nuk është e furnizuar me infrastrukturë, koeficienti paraqet vlerën e plotë 1.

Kur zona është e furnizuar me infrastrukturë, toka truall kompensohet me shtesë të truallit.

$$K_i = K_{rr} + K_u + K_e$$

Form. 9

Ku:

Krr: koeficienti i plotësimit me rrugë;

Ku: koeficienti i furnizimit me ujë;

Ke: koeficienti i furnizimit me energji.

a) Zonë e papajisur me infrastrukturë:

- me rrugë automobilistike;
- me linjë të furnizimit me ujë;
- me linjë të furnizimit me energji elektrike.

b) Zonë e pajisur me infrastrukturë:

- me rrugë automobilistike;
- me linjë të furnizimit me ujë;
- me linjë të furnizimit me energji elektrike.

Lloji i zonës	Krr	Ku	Ke
Zone e papajisur me infrastrukturë	0,4	0,3	0,3
Zonë e pajisur me infrastrukturë	0,7	0,6	0,4

Diapazoni i koeficientit të infrastrukturës (Ki) = 1,0 - 1,7

3. Koeficienti i zhvillimit (Kzh)

a) Zona vila rezidenciale (Intensiteti i ndërtimit (i) = 0,4 – 0,6, Kzh = 1,0)

b) zona hotelesh komerciale (Intensiteti i ndërtimit (i) = 0,6 – 0,8, Kzh = 1,3)

c) zona hotelesh komerciale (Intensiteti i ndërtimit (i) = 0,8 – 1,2, Kzh = 1,7)

Intensiteti i ndërtimit (i) paraqet raportin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore mbi

sipërfaqen e përgjithshme të truallit. Ky intensitet përcaktohet në studimet urbanistike.

Diapazoni i koeficientit të zhvillimit (K_zh) = 1,0 - 1,7

Në përfundim:

Diapazoni i koeficientit të zonimit: $K_z = 1,0 - 1,8$

Diapazoni i koeficientit të infrastrukturës: $K_i = 1,0 - 1,7$

Diapazoni i koeficientit të zhvillimit: $K_zh = 1,0 - 1,7$

Duke zbatuar formulën fillestare (formula 8): $K_u = K_z \times K_i \times K_zh$

Rezulton:

Min: $K_u = 1,0 \times 1,0 \times 1,0 = 1,0$

Max: $K_u = 1,8 \times 1,7 \times 1,7 = 5,2$

Diapazoni i koeficientit të urbanizimit (K_u) = 1,0 – 5,2

2. Zonat jashtë studimeve turistike

Për zonat jashtë studimeve të miratuara, por brenda vijës kufizuese të zonës turistike, duhet futur një koeficient korrektimi në formulën e mëposhtme:

$V_t = \frac{K_u}{2} \times K_d$ Form. 10

K_u : K_d është distanca e tokës nga vija ujit e shprehur në km.

Diapazoni i K_d : 0,17-0,50. Nëse rezulton jashtë këtyre kufijve, do të zbatohet kufiri përkatës më i ulët ose më i lartë.

ANEKSI 4

BURIMET REFERUESE QË DUHET TË PËRDOREN NGA EKSPERTËT

Vjetari Statistikor i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

1.1 Vlerësimi potencial agroprodhues i tokave bujqësore. Grupi i specialistëve, Instituti i Studimit të tokave dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës.

1.3 Normat e interesit bankar: Banka e Shqipërisë.

1.4 Studimi i faktorëve që ndikojnë në rendimentin e kulturave bujqësore: Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Instituti i Studimit të Tokave-Tiranë.

1.5 Sipërfaqet e ujitura - Statistika të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit. Studimi i faktorëve që ndikojnë në rendimentin e kulturave bujqësore: Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Instituti i Studimit të Tokave-Tiranë.

1.6 Hartat topografike, gjeografike ose ekonomike të vendit dhe/ose rajoneve.

1.7 Instituti i Statistikave – të dhëna vjetore të zhvillimit ekonomik të rajoneve të vendit.

VENDIM

Nr.184, datë 28.4.2005

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR PËR TAKSËN E RRUGËS DURRËS-KUKËS

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për Hetimin e Destinacionit të Taksës së Rrugës Durrës-Kukës.

II. Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë, 5 nga shumica dhe 4 nga opozita parlamentare.

III. Kryetari i Komisionit do të jetë përfaqësuesi i opozitës.

IV. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij në një afat prej tre javësh nga data e miratimit të

këtij vendimi.

V. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit të marrë të gjitha masat administrative të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2004

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur dhe mbështetur veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si institucion kushtetues që merret me përgatitjen, mbikëqyrjen, kontrollin dhe verifikimin e të gjitha aspekteve, që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor dhe me shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve;

duke vlerësuar rolin dhe kontributin e të gjitha forcave politike për krijimin e një klime të përshtatshme për zhvillimin e një procesi zgjedhor të drejtë e të ligjshëm;

duke përkrahur dhe vënë në jetë rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare që asistojnë reformën e procesit zgjedhor në Shqipëri, për krijimin e kuadrit të domosdoshëm ligjor për zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme;

pasi u njoh me Raportin Vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për Vitin 2004, në bazë të nenit 29 pika 10 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, konstaton:

- Është dëshmuar vullnet dhe është krijuar një përvojë e mirë dhe profesionalizëm në administrimin e zgjedhjeve, në krijimin e infrastrukturës zgjedhore dhe në trajnimin e administratës zgjedhore.

- Është bërë vlerësim pozitiv për punën e këtij institucioni nga organizmat ndërkombëtarë e veçanërisht reporterët e Këshillit të Europës.

- Është zhvilluar bashkëpunimi dhe transparenca me forcat politike të vendit, në kuadër të zhvillimit të një veprimtarie vendimmarrëse, në përputhje me ligjin.

Kuvendi kërkon që për vitin 2005 t’u kushtohet vëmendje e veçantë këtyre objektivave:

- Angazhim maksimal dhe korrektësi në zbatimin e legjisllacionit zgjedhor për organizimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të ndershme.

- Miratimin e Rregullores së Re, në zbatim të kërkesave të Kodit Zgjedhor, e cila do të përcaktojë qartë dhe do të precizojë aspektet më të rëndësishme të veprimtarisë së KQZ-së, veçanërisht në mënyrën e përgatitjes së mbledhjes së KQZ-së dhe veprimet që kryhen gjatë saj prej anëtarëve të KQZ-së, përfaqësuesve të partive politike, përfaqësuesve të kandidatëve të pavarur, vëzhguesve, medias etj.

- Të mbajë në qendër të vëmendjes rekomandimet e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare, në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës zgjedhore, kushteve të punës së komisioneve zgjedhore dhe identifikimin e nevojave logjistike për funksionimin normal të tyre gjatë procesit të ardhshëm zgjedhor.

- Të ngrejë në një nivel më të lartë bashkëpunimin me organet e qeverisjes vendore, duke mos shmangur komunikimin direkt me komisionet e niveleve më të ulëta.

- T’u kushtojë më shumë vëmendje komisioneve zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta, me qëllim aftësimin e tyre profesional mbi bazë trajnimesh të vazhdueshme.

- Të hartojë një axhendë të detajuar për organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme, si dhe të kontrollojë zbatimin e kësaj axhende.

Tiranë, më 21.4.2005

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE PËR VITIN 2004

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur dhe mbështetur veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si institucion i pavarur që merret me administrimin e deklarimit të pasurisë, të detyrimeve financiare dhe kontrollin e këtij deklarimi, sipas përcaktimeve të bëra në ligj për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe personat e lidhur me ta;

- duke vlerësuar rolin dhe kontributin e këtij institucioni për forcimin e strukturave përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit;

- duke përkrahur dhe nxitur veprimtarinë e Inspektoratit për përmirësimin e kuadrit të domosdoshëm ligjor për zhvillimin e një procesi sa më transparent të kontrollit të deklarimit të pasurive;

pasi u njoh me Raportin Vjetor të Inspektoratit të Lartë të Kontrollit të Deklarimit të Pasurive për Vitin 2004, në bazë të nenit 39 pika 1 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” dhe nenit 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, konstaton:

- është dëshmuar vullnet dhe është krijuar një përvojë e mirë dhe profesionalizëm në procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurisë dhe detyrimeve financiare të zyrtarëve të zgjedhur e të nëpunësve publikë të nivelit të lartë e të mesëm;

- është bërë vlerësim pozitiv dhe është rritur në mënyrë të dukshme bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, që kanë struktura homologe të specializuara në luftën antikorrupsion;

- është zhvilluar bashkëpunimi me institucionet shtetërore dhe transparenca e komunikimi në marrëdhëniet me publikun e median shqiptare, në kuadër të zhvillimit të një veprimtarie vendimmarrëse sa më të drejtë dhe në përputhje me ligjin.

Kuvendi kërkon që për vitin 2005 t’u kushtohet vëmendje e veçantë këtyre objektivave:

- Angazhim maksimal dhe korrektësi në zbatimin e legjislacionit për administrimin e deklarimit të pasurisë, të detyrimeve financiare dhe kontrollin e këtij deklarimi, sipas përcaktimeve të bëra në ligj për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe personat e lidhur me ta.

- Thjeshtim të dokumentacionit për deklarimin e pasurive, për ta bërë më të lehtë këtë proces si për subjektet që mbartin detyrimin për deklarim, ashtu edhe për kontrolluesit.

- Propozim të ndryshimeve të domosdoshme në legjislacion, të cilat i japin mundësinë ligjore këtij institucioni të kontrollojë llogaritë bankare të politikanëve jashtë vendit.

- Trajnim të vazhdueshëm të inspektorateve të ulëta për të përmirësuar cilësinë e shërbimit që ato ofrojnë në procesin e deklarimit.

Tiranë, më 28.4.2005

VENDIM

Nr.267, datë 28.4.2005

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES, PËR SHPENZIMET E KRYERA PËR PËRBALLIMIN E EMERGJENCAVE NGA RESHJET E BORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19, 20, shkronja “a”, e 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të

nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, zëri “Mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, për shpenzimet e kryera për përballimin e situatës së krijuar nga reshjet e borës.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.268, datë 28.4.2005

PËR PËRCAKTIMIN E KUFIJVE MAKSIMALË TË LEJUESHËM PËR AKTIVET DHE INVESTIMET E AKTIVEVE, PËR MBULIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE, NGA SHOQËRITË E SIGURIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 105 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqëritë e sigurimeve, në realizimin e politikës së investimeve, të mbështeten në faktorët e përcaktuar në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shoqëritë e sigurimeve të mbulojnë provigjonet e tyre teknike vetëm me kategoritë e aktiveve, të përcaktuara në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
Në rrethana të veçanta dhe me kërkesë të shoqërisë së sigurimeve, Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve mund të pranojë, përkohësisht, por me vendim, kategori të tjera aktivesh, si mbulim për provigjonet teknike.
3. Shoqëritë e sigurimeve, përsa u përket aktiveve dhe investimeve të aktiveve, në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, mund të investojnë jo më shumë se:
 - a) 10 për qind të provigjoneve teknike bruto në çdo pjesë toke a ndërtesë ose në një numër pjesësh toke apo ndërtesash, afër njëra-tjetrës, sa mund të vlerësohen efektivisht si një investim;
 - b) 5 për qind të provigjoneve teknike bruto në aksione dhe letra të tjera me vlerë, të negociueshme si aksione, obligacione dhe instrumente të tjera të tregut të parasë dhe kapitalit të së njëjtës sipërmarrje apo hua, dhënë të njëjtit huamarrës. Ky kufi mund të ngrihet në 10 për qind, nëse sipërmarrja nuk investon më shumë se 20 për qind të provigjoneve teknike bruto në hua ose letra me vlerë të institucioneve emetuese a huamarrëse, ku në secilin prej tyre, ka investuar më shumë se 5 për qind të aktiveve të veta;
 - c) 5 për qind të provigjoneve teknike bruto në hua të pasiguruara, përfshirë 1 për qind për çdo hua të vetme, të pasiguar, përveç huave dhënë institucioneve të kreditit, shoqërive siguroese dhe sipërmarrjeve investuese;
 - ç) 3 për qind të provigjoneve teknike bruto në formën e parave në arkë;
 - d) 10 për qind të provigjoneve teknike bruto në aksione, letra të tjera me vlerë, që trajtohen si aksione dhe letra me vlerë debitore, të cilat nuk tregtohen në një treg të rregulluar;
 - dh) 15 për qind të provigjoneve teknike për kreditë hipotekore, sipas përcaktimit të pikës C.3

të listës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Shoqëritë e sigurimit detyrohen të përshtasin investimet e aktiveve në mbulimin e provigjoneve teknike, sipas drejtimeve dhe kufijve, të përcaktuara në këtë vendim, brenda datës 31 dhjetor 2005.

5. Ngarkohen Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve dhe shoqëritë e sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

SHTOJCA NR.1

- Natyra e përgjegjësive të marra përsipër;
- Monedha, në të cilën janë marrë përsipër përgjegjësitë;
- Kohëzgjatja e përgjegjësive ekzistuese;
- Shkalla e pasigurisë në përgjegjësitë ekzistuese, në vlerë dhe në kohën e ndodhjes së dëmeve;
- Tatimi, duke pasur parasysh trajtimin tatimor të investimeve të ndryshme dhe pozicionin tatimor të shoqërive të sigurimeve;
- Kufizimet statutores, ligjore ose vullnetare, për mënyrën e investimit të fondeve;
- Madhësia e asetëve, në raport me përgjegjësitë dhe në terma absolutë;
- Të ardhurat e pritshme afatgjata nga investimet e llojeve të ndryshme të asetëve;
- Vlerësimet statutores dhe niveli minimal i kërkuar i likuiditeteve, për të përmbushur detyrimet;

- Përgjegjësitë e së ardhmes;
- Gjendja e portofolit ekzistues;
- Strategjitë e ndjekura nga shoqëritë analoge;
- Madhësia e rrezikut, që investitori është në gjendje të marrë përsipër;
- Nevoja për shpërndarjen e investimeve, për të shmangur mbështetjen e tepërt, në një klasë të caktuar investimesh;
- Objektivat e shoqërisë së sigurimeve.

SHTOJCA NR.2

A. Investime

A.1 Letra me vlerë debitore, të emetuara ose të garantuara nga shteti shqiptar;

A.2 Obligacione, hua, mjete të tjera monetare dhe instrumente të tregut të parasë e të kapitalit, që krijohen apo vërtetojnë borxhin, e emtuar dhe të garantuar, nga organet e qeverisjes qendrore a vendore ose nga një shoqëri publike, me seli në Republikën e Shqipërisë (letra me vlerë të qeverisë dhe borxhi publik);

A.3 Para në arkë dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, depozita me institucionet e kredive dhe çdo institucion tjetër, të autorizuar për të pranuar depozita, me seli në Republikën e Shqipërisë;

A.4 Certifikata depozitash dhe letra të tjera me vlerë, të lëshuara nga banka të licencuara, nga Banka e Shqipërisë;

A.5 Aksione në shoqëri sigurimi dhe shoqëri risigurimi;

A.6 Aksione të lëshuara me miratimin e Komisionit të Letrave me Vlerë, të Bursës së Tiranës;

A.7 Obligacione dhe letra të tjera me vlerë, të lëshuara nga qeveritë dhe bankat qendrore të vendeve të Bashkimit Europian, SHBA-së dhe Japonisë.

A.8 Aksione dhe letra të tjera me vlerë të tregtuara në bursat kryesore të vendeve të Bashkimit Europian, SHBA-së dhe Japonisë;

A.9 Dokumente, që vërtetojnë pjesëmarrjen me aksione investimesh, të licencuara me seli

qendrore në vendet e Bashkimit European, Japonisë dhe SHBA-së, kryesisht në bursat e vendeve përkatëse;

A.10 Toka, ndërtesa dhe të drejta mbi pasuritë e patundshme në Republikën e Shqipërisë.

B. Debitorë dhe kërkesëpagesa

B.1 Shumat, që detyrohen nga risiguruesit, përfshirë pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike;

B.2 Depozitat dhe shumat që detyrohen nga marrjet në sigurim;

B.3 Shumat, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risigurimet;

B.4 Kërkesëpagesat, që rrjedhin nga pjesët e shpëtuar dhe subrogimet;

B.5 Taksat e kthyeshme;

B.6 Kërkesëpagesat ndaj fondit të garancisë.

C. Të tjera

C.1 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç tokës dhe ndërtesave, të vlerësuara në bazë të amortizimit;

C.2 Interesat dhe qiratë e pagueshme;

C.3 Kreditë individuale hipotekare, vetëm për apartamente banimi.

VENDIM

Nr.269, datë 28.4.2005

PËR KRITERET DHE MASËN E MBULIMIT FINANCIAR TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR USHTARAKUN E FORCAVE TË ARMATOSURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 40 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura dhe pjesëtarët e familjes në ngarkim të tij, si dhe ushtari i shërbimit të detyrueshëm aktiv, që diagnostikohen apo kurohen në institucione shëndetësore, ushtarake apo civile, publike, brenda vendit, përfitojnë kujdes shëndetësor pa pagesë, vetëm në përputhje me sistemin e referimit, të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Shpenzimet për shërbimet e kujdesit shëndetësor, që, për arsye objektive, nuk ofrohen nga institucione shëndetësore publike, në bazë të vendimit të Komisionit Mjekësor të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, por që mund të bëhen në institucione shëndetësore, private, brenda vendit, të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, i parashikuar për këtë qëllim.

2. Kur vendoset që diagnostikimi apo kurimi të kryhet në institucione shëndetësore jashtë vendit, në bazë të vendimit të Komisionit Mjekësor të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, shpenzimet për diagnostikimin apo kurimin e ushtarakut të Forcave të Armatosura dhe të ushtarit të shërbimit të detyrueshëm aktiv, mbulohen në masën 100 për qind nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa shpenzimet për pjesëtarët e familjes në ngarkim të ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura mbulohen në masën 50 për qind dhe diferenca përballohet nga vetë përfituesi.

Shpenzimet e udhëtimit për ushtarakun aktiv të Forcave të Armatosura të përballohen në masën 80 për qind nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes dhe për pjesëtarët e familjes së tij 50 për qind, ndërsa shpenzimet e udhëtimit për ushtarin e shërbimit të detyrueshëm aktiv, të përballohen në masën 100 për qind nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ushtaraku në rezervë, lirim apo pension i Forcave të Armatosura dhe pjesëtarët e familjes

në ngarkim të tij, si dhe ushtari i shërbimit në rezervë kur sëmuret në shërbimin ushtarak, kur diagnostikohen apo kurohen në institucionet shëndetësore ushtarake apo civile, publike, përfitojnë kujdes shëndetësor pa pagesë, në përputhje me sistemin e referimit të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Kur shërbimet e kujdesit shëndetësor, sipas kësaj pike, për arsye objektive, nuk ofrohen nga institucionet shëndetësore publike, në bazë të vendimit të Komisionit Mjekësor të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, ato mund të bëhen në institucione shëndetësore private, brenda vendit. Në këtë rast, shpenzimet për këto shërbime mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, i parashikuar për këtë qëllim.

4. Kur për ushtarakun në rezervë, lirim apo pension të Forcave të Armatosura, në bazë të vendimit të Komisionit Mjekësor të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, vendoset që diagnostikimi apo kurimi të kryhen në institucionet shëndetësore jashtë vendit, shpenzimet të përballohen në masën 50 për qind nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa për pjesëtarët e familjes në ngarkim të tij të përballohen në masën 30 për qind nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes. Pjesa e mbetur të përballohet nga vetë përfituesi.

Kur ushtari i shërbimit në rezervë sëmuret gjatë shërbimit ushtarak, dhe në bazë të vendimit të Komisionit Mjekësor të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar vendoset të dërgohet për diagnostikim apo kurim në institucionet shëndetësore jashtë vendit, shpenzimet mbulohen në masën 100 për qind nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, i parashikuar për këtë qëllim.

Kur ushtaraku në rezervë, lirim apo pension i Forcave të Armatosura dhe ushtari i shërbimit në rezervë dërgohen për diagnostikim apo kurim në institucionet shëndetësore jashtë vendit, shpenzimet e udhëtimit mbulohen në masën 50 për qind nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes dhe 50 për qind nga ata vetë.

Kur pjesëtarët e familjes në ngarkim të ushtarakut rezervë, në lirim apo pension dërgohen për diagnostikim apo kurim në institucione shëndetësore jashtë vendit, shpenzimet e udhëtimit mbulohen në masën 30 për qind nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

5. Të drejtat e parashikuara në pikat 1,2,3 dhe 4 të këtij vendimi, gëzohen vetëm kur kohëzgjatja e shërbimit ushtarak është jo më pak se 1 vit, me përjashtim të ushtarit të shërbimit të detyrueshëm aktiv.

6. Ministria e Mbrojtjes, për ofrimin e shërbimeve të sipërpërmendura, u drejtohet qendrave mjekësore të shteteve me të cilat ka nënshkruar marrëveshje për këtë qëllim.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.11.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.270, datë 15.4.2005

PËR MIRATIMIN E PROJEKTKONTRATËS PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË
SHOQËRISË ANONIME “ARMO”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9117, datë 24.7.2003 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Armo”, Fier” me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projektkontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime “Armo”.
 2. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ARMO SHA
KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH
_____2005

Kjo kontratë lidhet më 2005 _____ ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, bulevardi Zhan d'Ark , e përfaqësuar nga Shkëlqesia e Tij, Ministri z. Anastas Angjeli (më poshtë referuar si “Shitësi”)

dhe _____, një shoqëri e krijuar sipas ligjeve të _____, (më poshtë “Blerësi), me seli në _____, e përfaqësuar nga z. _____, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor.

Meqenëse ekzistojnë këto kushte paraprake,

a) Armo sh.a. (më poshtë referuar si “Shoqëria”) është një shoqëri aksionare shtetërore, e krijuar rregullisht sipas së drejtës shqiptare me seli në Fier, lagjja 1 Maj, me kapital aksionar 6 456 576 000 lekë, të paguara plotësisht;

b) Shitësi është pronar i 6 456 576 aksioneve të zakonshme të shoqërisë, me një vlerë nominale prej 1000 lekë secili, që përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar të Shoqërisë;

c) Blerësi është një shoqëri e specializuar në sektorin e naftës;

d) Në mbështetje të ligjit nr.9117, datë 24.7.2003 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime Armo sh.a.” dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.150, datë 18.3.2005 “Për përcaktimin e madhësisë së paketës së aksioneve të kapitalit të shoqërisë anonime Armo, që u ofrohet investitorëve strategjikë”, Shitësi ka për qëllim t'i shesë Blerësit një numër prej 4 906 998 aksione të zakonshme të Shoqërisë, që përfaqësojnë 76% të kapitalit të saj aksionar.

e) Blerësi ka për qëllim të blejë 4 906 998 aksione të zakonshme të Shoqërisë, aktualisht të zotëruara nga Shitësi;

duke marrë në konsideratë sa më sipër, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Përveç termave të tjerë të përkufizuar gjetkë në këtë kontratë, për qëllimet e saj, fjalët dhe termat që vijnë do të kenë kudo kuptimin e mëposhtëm:

“Llogari” do të thotë llogaritë e Shoqërisë për vitin financiar të mbyllur në datën e fundit kontabël, duke përfshirë raportin zyrtar të ekspertëve kontabël të autorizuar mbi këto llogari, raportin përkatës të drejtorëve dhe shënimet për këto llogari;

“Kontratë” do të thotë kjo kontratë për blerje aksionesh, duke përfshirë si një pjesë përbërëse të saj, kushtet paraprake të mësipërme, si dhe shtojcat bashkëngjitur, të nënshkruara e të shkëmbyera nga dhe ndërmjet Blerësit dhe Shitësit;

“Mbyllje” do të thotë blerja dhe shitja e aksioneve, regjistrimi i Blerësit si aksionar i ri, pagesa e pjesës së çmimit të pagueshëm në datën e mbylljes dhe, në përgjithësi, nënshkrimi dhe shkëmbimi i gjithë dokumenteve dhe kryerja dhe përmbushja e gjithë detyrimeve, respektivisht të kërkuara për t’u realizuar dhe shkëmbyer, kryer dhe përmbushur në mbyllje, në përputhje me këtë kontratë, me qëllim që të mundësojë Blerësin të bëhet pronar legjitim i 76% të aksioneve të Shoqërisë;

“Data e mbylljes” do të thotë data në të cilën aktualisht mbyllja do të kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj kontrate, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të saj;

“Konsulentët” do të thotë këshilltarët e Shitësit për transaksionin objekt të kësaj kontrate, të emërtuar Banca IMI S.p.A., Bain & Company Italy dhe Studio Legate Tonucci — Organizatë Profesionale;

“Parapagesë” do të thotë shuma prej _____ (_____) paguar nga Blerësi në datën e mbylljes siç parashikohet në nenin 3 paragrafi 3, numri 1 i kontratës;

“Barrë” do të thotë çdo hipotekë, detyrim, peng, garanci, kufizim, e drejta e refuzimit të parë, e drejta e parablerjes, e drejtë ose interes i një pale të tretë, barrë ose interesa sigurimi të çdo lloji, ose çdo lloj tjetër marrëveshjeje preferenciale (duke përfshirë, pa kufizim, transferimin e një titulli ose të një marrëveshjeje mbajtje) që kanë pasoja të ngjashme;

“Forca madhore” do të thotë çdo urdhër, rregullore, ose direktivë qeveritare, e botuar në formën e ligjit ose jo, ose çdo sanksion me natyrë kombëtare ose ndërkombëtare, kryengritje, trazira, trazira civile, luftë (e deklaruar ose jo), aksione ose kërcënime për aksione grupesh ose individësh terroristë apo guerilie, greva ose lëvizje të tjera sindikaliste, zjarre, përmbytje, tërmete, ose ndonjë shkak tjetër që nuk është rezultat i fajit ose neglizhencës së palëve, ose secilës prej tyre, qofshin ose jo të ngjashme me sa më sipër, me kusht që një ngjarje e tillë të jetë jashtë kontrollit të palës së dëmtuar;

“Data e fundit kontabël” do të thotë 31.12.2004;

“Humbje” ose “Humbjet” do të thotë çdo dëm, kosto, shpenzime të kryera, humbje ose detyrime, në një shumë jo më të vogël se 50 000 euro (pesëdhjetë mijë), të cilat janë pasojë direkte dhe/ose indirekte e shkeljes së parashikimeve dhe garancive të specifikuara në nenin 5;

“Materiale” (dhe variantet e saj) do të thotë, në lidhje me një ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht, se kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht — që veçmas ose së bashku, ka një pasojë e ndikim domethënës ose plotësisht të kundërt (përkeqësues) në gjendjen ekonomike, pasurore, financiare dhe tregtare të Shoqërisë dhe/ose të veprimtarisë së saj në tërësi, në një mënyrë të tillë që vendimi për të kryer transaksionin do të ndikojë në të kundërt kurdo që kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht të njihet prej Blerësit, ose që kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht mund të shkaktojë një ndryshim material përkeqësues;

“Ndryshim material përkeqësues” do të thotë ndonjë nga ngjarjet në vijim:

a) një vendim i autoriteteve kompetente shqiptare për tërheqje, mbyllje ose pezullim të licencës së shoqërisë, të identifikuar në shtojcën D;

b) një vendim i detyrueshëm ligjor, i formës së prerë i një gjykate, që deklaron shoqërinë të falimentuar ose me paaftësi paguese;

c) fillimi nga shoqëria i akteve të likuidimit, në lidhje me vetë shoqërinë;

d) ndonjë ngjarje, ose seri ngjarjesh, që rrjedh si rezultat i menaxhimit apo veprimeve të shoqërisë, që përfshin një pagesë ose humbje, veçmas ose në tërësi, në një shumë jo më të vogël 1000 000 euro (një milion);

“Pala” ose “Palët” do të thotë Blerësi ose Shitësi ose të dy së bashku, siç mund të kërkohet në kontekst;

“Çmimi i blerjes” do të thotë çmimi që Blerësi i paguan Shitësit për blerjen e aksioneve, siç tregohet në nenin 3 dhe në përputhje me mekanizmin e përcaktuar aty;

“Deklarata për çmimin e blerjes” do të thotë deklarata e shkruar, në formën e rënë dakord në shtojcën A, të nënshkruar nga drejtuesi përkatës i çdo banke të caktuar nga Shitësi dhe të treguar në tabelën e paraqitur në nenin 3, që vërteton se çmimi i blerjes është kredituar në llogaritë e Shitësit ose të personave juridikë të tjerë të caktuar nga Shitësi në ato banka;

“Aksione” do të thotë një numër 4 906 998 aksione të zakonshme, plotësisht të paguara të Shoqërisë me një vlerë nominale prej 1000 lekë secili, numër i barabartë me 76 % të kapitalit aksionar të Shoqërisë. Aksionet përfaqësohen nga certifikata bashkëngjitur shtojcës B.

Titujt në këtë kontratë nuk kanë ndonjë ndikim në interpretimin e saj.

Neni 2

Qëllimi i kësaj kontrate

Në bazë të kushteve dhe afateve të kësaj kontrate, në datën e mbylljes Shitësi do t'i shesë Blerësit dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi aksionet dhe çdo të drejtë që u përket aksioneve, të lira nga çdo barrë, për një vlerë të barabartë me shumën e përcaktuar në nenin 3 dhe të pagueshme në mënyrën e parashikuar po aty.

Mbyllja e transaksionit, e parashikuar në këtë kontratë, që do të kryhet në datën e mbylljes, do të zhvillohet në zyrat e Shitësit në datën për të cilën do të bien dakord reciprokisht palët.

Neni 3

Çmimi i blerjes dhe metoda e pagesës

Çmimi i pranuar për çdo aksion është _____ () dhe, kështu, shuma totale e çmimit të blerjes për aksionet është _____ (), dhe do të paguhet në përputhje me dispozitat e parashikuara këtu dhe sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Të drejtat e dividendëve do të lindin për secilin prej aksioneve nga data e mbylljes.

Shitësi do të paguajë totalin e çmimit të blerjes si më poshtë:

1. Në datën e mbylljes, parapagimi do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë rrjedhëse nr. _____ e hapur nga Banca IMI S.p.A, Swift Code _____, në Bank _____ Swift Code _____ si pjesë e çmimit total të blerjes;

2. Në datën e mbylljes, shuma prej _____ () do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë ekzistuese të Shitësit nr. _____, e hapur me _____ Bank, Swift Code _____;

3. Në ditën e njëqind e tetëdhjetë pas datës së mbylljes, shuma e mbetur prej _____ () do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë ekzistuese të Shitësit, të treguar në paragrafin 2.

Nëpërmjet kësaj kontrate, Blerësi është shprehimisht i autorizuar nga Shitësi t'i paguajë parapagimin drejtpërdrejt këshilltarëve, në llogarinë bankare të përmendur më sipër, si shpërblim për suksesin, për shërbimet këshillimore të konsulentëve në shitjen e aksioneve.

Në datën e mbylljes, Blerësi merr përsipër t'i paraqesë Shitësit një garanci bankare për përmbushjen e detyrimeve, të lëshuar në favor të Shitësit për shumën e barabartë me shumën e mbetur për t'u paguar sipas paragrafit 3 pika 3, këtu sipër, në formën e përshkruar në shtojcën C.

Neni 4

Mbyllja

Në mbyllje:

a) Shitësi:

1. Do të dorëzojë certifikatën që përfaqëson aksionet e regjistruara rregullisht në favor të Blerësit, në përputhje me legjislacionin shqiptar;

2. Do të nënshkruajë dhe dorëzojë, dhe/ose të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e dokumenteve të tjera të nevojshme sipas legjislacionit shqiptar, për t'i dhënë Blerësit një titull të mirë dhe të tregtueshëm mbi aksionet dhe për të realizuar në mënyrën e duhur qëllimin e kësaj kontrate;

3. Do të bëjë të mundur dorëheqjen e të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë, duke filluar nga data e mbylljes;

4. Do t'i kthejë Blerësit garancinë bankare për tenderin që i është dorëzuar, së bashku me ofertën detyruese.

dhe

b) Blerësi do t'i dorëzojë Shitësit dokumentet e mëposhtme:

1. mandatpagesën e çmimit të blerjes në shumën e caktuar në nenin 3 paragrafi 3 pikat 1 dhe

2;

2. garancinë bankare në përputhje me nenin 3 paragrafi 5;
3. një ekstrakt nga regjistri tregtar, në lidhje me blerësin lëshuar brenda 10 (dhjetë) ditëve pune para mbylljes;
4. një certifikatë të noterizuar të pozitës së mirë të Blerësit;
5. një kopje të noterizuar të licencës për telekomunikacion të Blerësit, në vendin e tij të krijimit;
6. një kopje të noterizuar të vendimit të organeve kompetente të Blerësit, që miratojnë blerjen e aksioneve;
7. opinionin ligjor të lëshuar nga (emri i avokatit) në një formë të pranueshme për Shitësin, që konfirmon autoritetin e Blerësit për lidhjen e kësaj kontrate dhe zbatimin e detyrimeve të saj.

Në mbyllje, Blerësi do të fitojë titullin mbi aksionet, në datën e mbylljes dhe do të përfitojë çdo dividend të deklaruar ose të paguar, si dhe do të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera që lidhen me to, duke filluar nga data e mbylljes.

Shitësi do të bëjë të mundur që në datën e mbylljes, ose në çdo datë tjetër pas mbylljes, të vendosur nga Blerësi, thirrjen e mbledhjes së aksionarëve të Shoqërisë, rendi i ditës i së cilës do të përcaktohet në marrëveshje me Blerësin dhe do të përfshijë — ndër të tjera — emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, në vend të atyre që do të kenë dhënë dorëheqjen; Blerësi do të ketë të drejtën të përcaktojë emrat e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, që do të emërohen pa cenuar kufizimet, në qoftë se ka të tilla, të parashikuara në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe në amendamentet e tij të mëvonshme, si dhe në dispozitat e tjera shqiptare statutores të aplikueshme.

Neni 5

Deklarimet dhe garancitë e Shitësit

Shitësi me anë të kësaj kontrate deklaron dhe garanton, në lidhje me Shoqërinë dhe me transaksionin të parashikuar prej kësaj kontrate, të gjitha çështjet që vijnë deri në datën e nënshkrimit të saj. Shitësi gjithashtu garanton se çdo garanci dhe deklarim do të jetë i vërtetë, i saktë dhe joçorientues, sikur të ishte bërë në datën e mbylljes.

5.1 Organizimi

Shoqëria është themeluar në mënyrën e duhur dhe ekziston rregullisht sipas ligjeve shqiptare, nuk është në pamundësi pagese dhe është plotësisht e aftë, me të drejta dhe autoritet të plotë, të zhvillojë e kryejë aktivitetin e saj siç e kryen aktualisht dhe të zotërojë asetet dhe pronat e saj siç i zotëron aktualisht. Shoqëria zhvillon aktivitet sipas një licence të vlefshme, siç tregohet në shtojcën E, dhe nuk ka shkelur asnjë prej afateve të kësaj licence.

5.2 Autorizimi

Të gjitha aktet legjislative dhe/ose procedurat e tjera të kërkuara prej legjislacionit shqiptar për t'u marrë nga Shitësi ose në emër të tij, për ta autorizuar atë të lidhë dhe të zbatojë këtë kontratë, janë ndërmarrë rregullisht dhe në mënyrën e duhur, kjo kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar nga Shitësi në mënyrën e duhur dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe të detyrueshëm të Shitësit ndaj tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e saj.

5.3 Mungesa e konflikteve

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj kontrate, realizimi i transaksionit të parashikuar nga kjo kontratë dhe plotësimi i kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj kontrate nga Shitësi nuk bie në konflikt, ose nuk rezultojnë në përbërje ndonjë shkelje ose mospërbushje, ose të krijojë ndonjë të drejtë për prishjen a përfundimin, anulimin ose përsheptimin e ndonjë detyrimi ose humbjeje të ndonjë përfitimi material, ose nuk krijon ndonjë pengesë mbi ndonjë biznes, aset ose pronë a pasuri të Shitësit, me ose sipas ndonjë dispozite, vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të zbatueshme për Shitësin.

5.4 Pronësia

Shitësi është pronari dhe përfituesi i vetëm ligjor i aksioneve në numrin e përcaktuar në nenet 1 dhe 2.

Aksionet janë të përcaktuara dhe të emetuara sipas rregullave dhe janë plotësisht të pagueshme.

Aksionet janë të lira dhe të çliruara nga çdo barrë e çfarëdolloji dhe Shitësi do të ketë të drejtë,

kompetencë dhe autoritet të plotë për t'i shitur, për t'ia kaluar pronësinë e tyre të tretëve, transferuar dhe dorëzuar aksionet në përputhje me afatet e kësaj kontrate.

Nuk ekziston asnjë kontratë a marrëveshje, rregullim ose detyrim që krijon ose vendos ndonjë barrë në lidhje me aksionet ose ndonjë numër aksionesh të autorizuara, por të paemtuara në kapitalin e Shoqërisë. Asnjë person nuk pretendon të ketë të drejtën e ndonjë barre në lidhje me ndonjë nga aksionet.

Përveç kësaj kontrate, nuk ekziston asnjë kontratë a marrëveshje, rregullim ose detyrim që kërkon krijimin, akordimin, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin, ose dhënien një personi të së drejtës (të kushtëzuar ose jo) të kërkojë akordimin, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e ndonjë aksioni në kapitalin e Shoqërisë (duke përfshirë, pa kufizim, një mundësi ose të drejtë parablerjeje ose kthimi).

5.5 Filialet

Shoqëria nuk ka ndonjë filial.

5.6 Llogaritë financiare

Llogaritë financiare janë përgatitur mbi baza të rregullta e të qëndrueshme në përputhje me ligjin shqiptar dhe me standardet, parimet dhe praktikatat e zbatuara lokale.

5.7 Regjistrat kontabël dhe libra të tjerë të Shoqërisë

Regjistrat kontabël dhe librat e Shoqërisë, në zotërim ose nën kontrollin e saj, janë të azhurnuara, të mbajtura në mënyrën e duhur dhe të gjitha regjistrimet në regjistrat dhe librat kontabël janë mbajtur në përputhje të plotë me të drejtën shqiptare dhe me standardet, parimet dhe praktikatat e zbatuara ndërkombëtare.

5.8 Mungesa e ndryshimeve materiale

Biznesi i Shoqërisë është zhvilluar në mënyrë normale duke e konsideruar atë si një preokupim të vazhdueshëm; dhe asnjë ndryshim thelbësor nuk ka ndodhur në aktivin dhe pasivin e treguar në llogaritë dhe nuk ka asnjë ulje të vlerës reale neto të aktivitetit të Shoqërisë në bazë të vlerësimeve të bëra dhe të përlllogaritura në llogaritë.

Që nga data e fundit kontabël, Shoqëria është drejtuar dhe ka operuar në mënyrën e duhur dhe Shitësi nuk ka dijeni se vetë Shitësi dhe/ose Shoqëria ka:

- hyrë në ndonjë marrëveshje, vlera e të cilës kalon 100 000 euro, me përjashtim të atyre të raportuara në shtojcën E;

- marrë përsipër ndonjë detyrim ose përgjegjësi materiale;

- kryer ndonjë veprim tjetër që mund të shkaktojë që ndonjë nga deklaratat ose garancitë e Shitësit që përmbahen në këtë kontratë, të bëhen të pavërteta ose të parregullta.

Që prej 31.3.2005 Shoqëria nuk ka:

- a) pësuar asnjë ndryshim material dhe përkeqësues në asetet, pronat ose në aktivitetet e saj të biznesit;

- b) pësuar asnjë ngjarje ose rrethanë materiale në lidhje me asetet, biznesin ose pronat e saj, që rrezikon materialisht të pengojë, ndalojë, dëmtojë ose të cenojë në ndonjë mënyrë tjetër materiale dhe përkeqësuese rezultatet e veprimtarisë së saj në tërësi;

- c) hyrë në asnjë transaksion ose kontratë, ose nuk ka ndryshuar ose përfunduar asnjë transaksion ose kontratë që në mënyrë të arsyeshme mund të sillte një ndryshim material dhe përkeqësues për asetet, pronat dhe aktivitetet e biznesit të saj;

- d) shitur, transferuar, vënë peng, dhënë me qira ose disponuar në ndonjë mënyrë tjetër asetet ose pronat që ajo zotëron;

- e) punësuar personel ose nuk e ka rritur shkallën e kompensimit të pagueshëm ose që do të bëhet i tillë ndaj punonjësve, përveç rritjes të bërë sipas praktikave të mëparshme në përputhje me çdo shpërblim ekzistues ose me plane të tjera ose nuk ka ndryshuar organizimin e punës së saj në asnjë mënyrë materiale;

- f) fituar asnjë pasuri të paluajtshme ose nuk ka bërë as edhe një shpenzim kapitali (të prekshëm ose të paprekshëm) që kalon shumë 100 000 euro;

- g) fituar ose poseduar, në çfarëdolloj forme, interesa në kapitalin e shoqërive të tjera ose nuk ka fituar, poseduar ose hyrë në marrëdhënie qiraje (si qiramarrës ose qiradhënës) për ndonjë biznes ose pjesë biznesi;

h) deklaruar ose paguar asnjë dividend me përjashtim të shumës _____ lekë, që është pjesë e dividendit të 2004, ose nuk ka blerë ose fituar në ndonjë mënyrë tjetër interesa në pasurinë e saj (equity);

i) rënë dakord për të bërë ndonjë nga të mësipërmet.

Shitësi garanton se ndërmjet datës së ekzekutimit të kësaj marrëveshjeje dhe mbylljes, do të sigurojë që:

a) Shoqëria do të drejtojë biznesin e saj në përputhje me interesat e saj të biznesit dhe në rrugën e biznesit të zakonshëm, nga data e nënshkrimit të marrëveshjes dhe në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm, nenet e tij për shoqëritë dhe rregullat e brendshme në të gjitha aspektet materiale dhe

b) Shoqëria mban të pacenuar organizimin, klientët dhe personelin e saj të biznesit.

Shoqëria nuk do të bëjë asnjë shpenzim ose nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim pa miratimin paraprak nga ana e përfaqësuesit të Blerësit.

5.9 Taksat dhe konfliktet

Shoqëria ka depozituar, në kohën e duhur, të gjitha deklaratat për taksat periodike dhe vjetore që parashikohen në ligjet për taksat që zbatohen për Shoqërinë. Këto deklarata tatimore janë përgatitur rregullisht dhe në mënyrën e duhur dhe të gjitha taksat dhe detyrimet direkte ose indirekte të pagueshme, janë paguar plotësisht dhe në kohë. Përsa më sipër është lëshuar nga autoritetet tatimore shqiptare një vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore ashtu siç tregohet në shtojcën F.

Nuk ekziston asnjë konflikt në proces ose potenciali, me përjashtim të atyre të treguara në shtojcën G.

5.10 Asetet e prekshme

Shoqëria ka titull pronësie të plotë, të mirë dhe të tregtueshëm mbi të gjitha asetet dhe pronat e saj, të renditura në shtojcat H, I dhe J (duke përfshirë pronat individuale dhe të paluajtshme), që ose janë pasqyruar në llogaritë e datës së fundit kontabël, ose që janë fituar pas kësaj date, dhe ky titull nuk është objekt i ndonjë kufizimi, hipoteke, pengu, barre, detyrim ose të drejtë të çfarëdolloji në përfitim të të tretëve.

5.11 Asetet e paprekshme

Shoqëria është pronarja e vetme dhe ekskluzive e markave tregtare, patentave, e emrave tregtarë, know-how-ye dhe të çdo të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale të saj të nevojshme për zhvillimin e biznesit të saj siç tregohet në shtojcën K, si dhe ka të drejtë t'i përdorë këto dhe nuk ka cenuar asnjë markë tregtare, patentat, emër tregtar, know-how dhe asnjë të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale.

Shoqëria është licencuar në mënyrën e duhur për përdorimin e softuer-ëve të saj.

Këto asete të paprekshme janë plotësisht të përdorshme nga ana e Shoqërisë pa qenë nevoja për pagimin e ndonjë licence, tarife ose të ndonjë detyrimi tjetër të ngjashëm.

5.12 Marrëveshjet

Kjo marrëveshje në çdo pikëpamje nuk ndikon në vlerën, vazhdimësinë, efektshmërinë dhe ekzekutimin e marrëveshjeve midis kompanisë dhe shitësve me pakicë të saj, siç specifikohet në shtojcën L. Prandaj marrëveshjet midis kompanisë dhe shitësve me pakicë të saj do të mbeten të vlefshme, të efektshme dhe të detyrueshme, në përputhje me kushtet dhe termat e tyre respektivë.

5.13 Punonjësit

Të gjithë punonjësit janë të regjistruar rregullisht në librat dhe regjistrat përkatës, së bashku me shpërblimet totale që i paguhen secilit prej tyre, në përputhje me ligjet dhe rregullat e zbatueshme. Lista e punonjësve të Shoqërisë dhe pagat e tyre jepen në shtojcën M.

Shoqëria ka bërë të gjitha depozitimet dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet që kërkohen për t'u bërë ose për t'u ndërmarrë sipas ligjeve e rregullave të zbatueshme për sigurimet shoqërore, për punën dhe mirëqenien në lidhje me secilin nga punonjësit. Të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe mirëqenies në bazë të ligjeve dhe rregullave, si dhe të kontratës kolektive, nëse ka të tillë, janë paguar plotësisht.

Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, bordit të drejtorëve ose çdo ekspert kontabël i Shoqërisë dhe çdo punonjës ka marrë vitin e fundit financiar vetëm shumat e paraqitura në llogaritë dhe asnjë nga ata nuk ka të drejtë të marrë ndonjë shumë tjetër, përveç atyre të treguara në këto llogari.

5.14. Pajtueshmëria me ligjin

Deri në datën e mbylljes, Shoqëria nuk ka shkelur asnjë statut, ligj, rregull, rregullore, urdhër,

dekret, direktivë, leje ose kërkesa të ngjashme të zbatueshme ndaj aseteve dhe pronave (qofshin këto të luajtshme ose të paluajtshme, të prekshme ose të paprekshme, të zotëruara, të licencuara, të disponuara me qira ose ndryshe) ose ndaj kontratës dhe të drejtat të parashikuara prej saj, të cilat mund të kenë një ndryshim material përkeqësues mbi aktivitetin e saj.

Shoqëria zotëron në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme, pa i shkelur ato, të gjitha lejet materiale, licencat dhe miratimet ose autorizimet e tjera që kërkojnë nga statutet, ligjet, rregullat, rregulloret, urdhrat, dekretet ose direktivat e zbatueshme, në lidhje me pronësinë, përdorimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e biznesit të saj ose të çdo aseti dhe prone të saj, ose të çdo kontrate dhe të drejte me të cilat Shoqëria është e lidhur.

Procesi i privatizimit të Shoqërisë dhe përzgjedhja e Blerësit si kandidat fitues kryhet në përputhje me ligjin nr.9117, datë 24.7.2003 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Armo” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore.

5.15 Garancitë, detyrimet dhe dëmshpërblimet

Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të papaguar dhe nuk ka rënë dakord të krijojë ose të marrë kapital hua, as të marrë borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes, më përjashtim të atyre të treguara në shtojcën N.

Shoqëria nuk është palë dhe nuk është përgjegjëse në bazë të ndonjë marrëveshjeje garancie, dëmshpërblimi ose marrëveshjeje tjetër për të siguruar ose marrë përsipër ndonjë detyrim financiar ose detyrim tjetër në lidhje me detyrimet e një pale të tretë.

5.16 Mbyllja e Shoqërisë, vënia në administrim dhe pamundësia e pagesës

Asnjë urdhër nuk është nxjerrë, asnjë ankesë nuk është paraqitur, ose asnjë vendim nuk është marrë për mbylljen e Shoqërisë ose për emërimin e ndonjë likuidatori të përkohshëm për Shoqërinë, si dhe asnjë urdhër nuk është nxjerrë për vënie në administrim të Shoqërisë; dhe Shoqëria nuk është e insolvente ose e paafte të paguajë borxhet e saj.

5.17 Pullat e taksës, taksat dhe detyrimet e tjera

Nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pullat, taksa ose detyrime të tjera në lidhje me këtë kontratë dhe me transferimin e aksioneve në emër të Blerësit.

5.18 Shtojcat

Shtojcat e mëposhtme që i janë bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje do të konsiderohen si pjesë përbërëse e saj:

Shtojca A: Deklarata e çmimit të blerjes;

Shtojca B: Certifikata e aksioneve;

Shtojca C: Garanci bankare;

Shtojca D: Licenca e Shoqërisë;

Shtojca E: Marrëveshjet e nënshkruara nga Shoqëria, pas datës së fundit kontabël;

Shtojca F: Raporti mbi çështjet tatimore;

Shtojca G: Raporti në lidhje me çështjen në proces;

Shtojca H: Lista e pasurive të paluajtshme të Shoqërisë;

Shtojca I: Lista e impianteve industriale ekzistuese dhe mjeteve të Shoqërisë;

Shtojca J: Lista e pajisjeve dhe aseteve të Shoqërisë (inventari);

Shtojca K: Lista e licencave për markat tregtare, patentat dhe softuer-ët e Shoqërisë;

Shtojca L: Lista e kontratave të nënshkruara nga Shoqëria me shitësit me pakicë të saj;

Shtojca M: Lista e punonjësve të Shoqërisë dhe pagat e tyre;

Shtojca N: Marrëveshjet e huasë të nënshkruara nga Shoqëria;

Shtojca O: Plani i biznesit i Blerësit.

Për të shmangur çdo dyshim, Shitësi garanton dhe deklaron se përmbajtja e shtojcave të mësipërme është e vërtetë dhe e saktë dhe do të jetë e tillë në datën e mbylljes.

Neni 6

Deklarimet dhe garancitë e Blerësit

Blerësi i bën deklaratimet dhe ia jep garancitë e mëposhtme Shitësit. Secila prej tyre do të jetë e vërtetë dhe e saktë në datën e mbylljes.

6.1 Organizimi

Blerësi është një shoqëri e themeluar, e organizuar dhe që ekziston rregullisht sipas së drejtës

_____, me aftësi paguese, me kompetencë dhe autoritet të plotë të kryejë aktivitetin e saj, siç e kryen aktualisht, dhe të zotërojë asetet dhe pronat e saj, siç i zotëron aktualisht.

6.2 Autorizimi

Të gjitha aktet e Shoqërisë dhe/ose procedurat e tjera që kërkohen të ndërmerren nga ose për t'u marrë, nga ose në emër të Blerësit, për ta autorizuar atë të lidhë dhe të zbatojë këtë kontratë, janë ndërmarrë rregullisht dhe në mënyrën e duhur, kjo kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar nga Blerësi në mënyrën e duhur dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe të detyrueshëm ndaj tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e saj.

Nënshkrimi i kësaj kontrate nuk kërkon ndonjë njoftim të mëtejshëm ose depozitim, aprovimin, autorizimin, ose çfarëdo instrument tjetër, nga ndonjë autoritet publik ndërkombëtar ose kombëtar, ose nga ndonjë autoritet tjetër qeveritar ose rregullator të vendit të Blerësit, përveç për _____.

6.3 Mungesa e komisionerëve

Blerësi nuk ka detyrime për të paguar ndonjë komision, tarifë ndërmjetësimi ose pagesa të ngjashme, ose komisione në lidhje me transaksionin e parashikuar në këtë kontratë, pagimi i të cilave të mund të kërkohej në mënyrë të vlefshme nga Shoqëria ose Shitësi.

6.4 Mungesa e konflikteve

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj kontrate, përfundimi i transaksioneve të parashikuara nga kjo kontratë dhe plotësimi i kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj kontrate nga Blerësi nuk bie në konflikt ose nuk rezulton të përbëjë ndonjë shkelje ose mospërbushje, ose të krijojë ndonjë të drejtë për prishjen a përfundimin, anulimin ose përsheptimin e ndonjë detyrimi ose humbje të ndonjë përfitimi material, ose nuk krijon ndonjë barrë mbi ndonjë biznes, asetet ose pronë a pasuri të Blerësit, sipas ndonjë dispozite të (i) statutit të Blerësit ose të dokumenteve të tjera të themelimit, ose (ii) të ndonjë kambiali, obligacioni, hipoteke, marrëveshje, akt i trustit, licencë, qira, kontratë ose marrëveshje, në të cilat Blerësi është palë, ose (iii) të ndonjë vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të zbatueshme për Blerësin ose mbi biznesin, asetet ose pronat e Blerësit.

Nënshkrimi i kësaj kontrate nuk përbën shkelje të ndonjë ligji ose dhe të vetë akteve të Shoqërisë së Blerësit që mund të ndikojë në vlefshmërinë ose në forcën detyruese të kësaj kontrate.

6.4 Due Diligence

Blerësi deklaron se ka drejtuar mbikëqyrjen e *due diligence* të biznesit dhe veprimtarisë së Shoqërisë dhe se nuk ka mbështetur dhe nuk është duke u mbështetur në ndonjë deklarament ose garanci nga Shitësi, përveç atyre që përmbahen specifikisht në këtë kontratë.

Neni 7

Detyrime të tjera të Blerësit

7.1 Mbajtja e selisë në Shqipëri

Blerësi do të mbajë selinë e Shoqërisë në Republikën e Shqipërisë.

7.2 Investimet dhe plani i biznesit

Blerësi do të zhvillojë, me përpjekjet e tij më të mira, aktivitetet e Shoqërisë, me qëllim që ta bëjë këtë biznes më konkurrues dhe efektiv në treg, në përputhje me planin e tij të biznesit siç përshkruhet në shtojcën 0.

Në mënyrë të veçantë, Blerësi do të zbatojë brenda periudhës së parashikuar të paktën 80% (tetëdhjetë) të shumës së investimeve të përshkuara në planin e biznesit.

Në rast se pas tre vjetësh nga nënshkrimi i kësaj kontrate, Blerësi nuk do të ketë plotësuar detyrimet e mësipërme në lidhje me investimet e parashikuara deri në vitin e tretë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit shumën prej _____ (_____), me përjashtim të rastit kur mosplotësimi i tyre nuk varet prej Blerësit për çfarëdo arsyeje.

7.3 Pronësia mbi aksionet

Blerësi do të vazhdojë të zotërojë aksionet për të paktën _____ vjet, duke filluar nga mbyllja, përveçse kur Shitësi miraton ndryshe. Në rast se Blerësi shkel këtë detyrim, do t'i paguajë Shitësit sasinë prej _____ (_____), me përjashtim të rastit kur shkelja nuk varet prej Blerësit për çfarëdo arsyeje.

Neni 8
Kushtet e mbylljes

Detyrimi i Blerësit për të blerë aksionet dhe detyrimi i Shitësit për t'ia shitur ato Blerësit, janë çështje të plotësimit ose të heqjes dorë, në ose përpara datës së mbylljes, të kushteve të mëposhtme:

8.1 Autorizimet

Të gjitha autorizimet, pëlqimet, urdhrat ose miratimet për, ose deklaratat, ose depozitimet, ose skadimi i afateve të periudhave pritëse, të vendosura nga ndonjë entitet ose autoritet qeveritar, të nevojshme për realizimin e shitjes dhe të blerjes së aksioneve, do të jenë marrë ose regjistruar, ose do të kenë ndodhur, ose sipas rastit, të hequr dorë prej tyre, nga autoriteti kompetent. Në mënyrë të veçantë:

a) Autoriteti i konkurrencës [vendi i krijimit të Blerësit] ose autoritet tjetër kompetent do të ketë lëshuar një vendim që miraton blerjen e aksioneve nga Blerësi, në përputhje me ligjet e aplikueshme të [vendi i krijimit të Blerësit].

b) Me kërkesën e Shitësit, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë do të marrë vendimin për ta paraqitur këtë kontratë për ratifikim në Kuvend, ratifikim i cili do të bëhet përpara pagimit të shumës së parashikuar në nenin 3 paragrafi 3 numri 3. Për shmangien e çdo dyshimi, është e kuptueshme që kjo kontratë është perfekte, e vlefshme dhe efektive, pavarësisht nga ratifikimi i saj nga Kuvendi.

8.2 Mungesa e vendimeve ose kufizimeve

Asnjë ligj i zbatueshëm ose vendim i miratuar, i hyrë në fuqi, i shpallur ose i detyrueshëm, ose i nxjerrë nga ndonjë entitet qeveritar, as edhe ndonjë kufizim a ndalim tjetër ligjor, që pengon ose ndalon kryerjen e blerjes dhe shitjes së aksioneve, nuk do të ketë fuqi juridike.

8.3 Kushtet për detyrimet e Blerësit

Detyrimi i Blerësit për t'ia blerë aksionet dhe për të paguar për to në mbyllje, është objekti i plotësimit (ose të heqjes dorë nga Blerësi), në ose përpara datës së mbylljes së kushteve të mëposhtme:

a) Deklarimet dhe garancitë

Deklarimet dhe garancitë e Shitësit të bëra në këtë kontratë do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale, në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe në momentin përkatës të mbylljes, sikur të jenë bërë në atë kohë, përveç rastit kur vlefshmëria e këtyre deklaratave dhe garancive ka shprehimisht një datë më të hershme (rast në të cilin këto deklarata dhe garanci do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale, në këtë datë më të hershme), përveç rasteve që, veç e veç ose në tërësi, nuk ka të ngjarë që në mënyrë të arsyeshme të sjellin një ndryshim material përkeqësues.

b) Plotësimi i detyrimeve të Shitësit

Shitësi do të ketë kryer ose përmbushur në të gjitha aspektet materiale të gjitha detyrimet dhe marrëveshjet e kërkuara nga kjo kontratë për t'u kryer ose përmbushur nga ana e Shitësit në kohën e mbylljes, përveç rasteve që, veç e veç ose në tërësi, nuk ka të ngjarë që në mënyrë të arsyeshme të sjellin një ndryshim material përkeqësues.

c) Mungesa e proceseve

Në kohën e mbylljes nuk do të ketë procese të filluara e të papërfunduara: (i) që kundërshtojnë, kufizojnë ose ndalojnë shitjen dhe blerjen e aksioneve prej Blerësit, (ii) që ndalojnë ose kufizojnë pronësinë ose menaxhimin prej Shoqërisë të ndonjë pjese materiale të biznesit ose të aseteve të Shoqërisë, (iii) që kërkojnë vendosjen e kufizimeve në aftësinë e Blerësit për të fituar, mbajtur ose ushtruar të drejtat e plota të pronësisë mbi aksionet, (iv) që kërkojnë të ndalojnë Blerësin të kontrollojë efektivisht ndonjë pjesë materiale të Shoqërisë; me kusht që nga ky kusht të jetë hequr dorë nga Blerësi për ndonjë padi, ankim ose procedim (me përjashtim të ndonjë padie, ankimi ose procedimi nga ndonjë entitet qeveritar) dhe në qoftë se Shitësi do t'i sigurojë Blerësit dëmshpërblim të kënaqshëm në mënyrë të arsyeshme për Blerësin, në formë e përmbajtje, për këto padi, ankime ose procedime.

8.4. Kushte për detyrimet e Shitësit

Detyrimi i Shitësit për të shitur, transferuar dhe dorëzuar aksionet është objekt i plotësimit (ose i heqjes dorë nga Shitësi), në ose përpara datës së mbylljes, i kushteve të mëposhtme:

a) Deklarimet dhe garancitë

Deklarimet dhe garancitë e Blerësit të bëra në këtë kontratë do të jenë të vërteta dhe të sakta

në të gjitha aspektet materiale në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe në kohën e mbylljes sikur të ishin bërë në këtë kohë, përveç rastit kur këto deklarata dhe garanci i referohen shprehimisht një date më të hershme (rast në të cilin këto deklarata dhe garanci do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale, në këtë datë më të hershme).

b) Plotësimi i detyrimeve të Blerësit

Blerësi do të ketë kryer ose përmbushur në të gjitha aspektet materiale të gjitha detyrimet dhe marrëveshjet e kërkuara nga kjo kontratë për t'u kryer ose përmbushur në kohën e mbylljes.

c) Mungesa e procedimeve

Nuk do të ketë procedime të filluara ose të papërfunduara nga ndonjë entitet qeveritar (ose procedime nga ndonjë person tjetër me mundësi të arsyeshme për të pasur sukses), që kundërshtojnë ose kërkojnë kufizimin ose ndalimin e shitjes dhe blerjes së aksioneve, ose që kërkojnë të përfitojnë nga Shitësi në lidhje me blerjen dhe shitjen e aksioneve të ndonjë dëmi që është material në lidhje me Shitësin; me kusht që nga një detyrim tillë të jetë hequr dorë nga Shitësi në lidhje me ndonjë padi, ankesë ose procedim (me përjashtim të ndonjë padie, ankimi ose procedimi nga një entitet qeveritar) dhe në qoftë se Blerësi i siguron Shitësit dëmshpërblim të kënaqshëm në mënyrë të arsyeshme për Shitësin, në formë dhe përmbajtje, në lidhje me këto padi, ankime ose procedime.

Neni 9

Dëmshpërblimi nga Shitësi

9.1 Detyrimet e Shitësit

Shitësi bie dakord të mos dëmtojë ose të kompensojë Blerësin ose Shoqërinë, sipas rastit, sipas kushteve dhe brenda kufijve, të rëna dakord më poshtë, nga çdo humbje që rrjedh nga ose që varet nga fakte, ose rrethana të ndodhura përpara datës së mbylljes edhe nëse humbja shfaqet pas kësaj date.

Çdo dëmshpërblim për t'u paguar nga ana e Shitësit sipas kësaj kontrate do të bëhet i pagueshëm vetëm kur humbja përkatëse, siç vendoset nga një gjykatë ose autoritet tjetër kompetent, është bërë e pagueshme.

Për qartësi, asnjë shkelje ose shkelje e pretenduar e ndonjë deklarate ose garancie nuk i jep të drejtë Blerësit të dëmshpërblehet, në rast se nga kjo shkelje nuk ka rezultuar ndonjë humbje për Shoqërinë, siç vendoset me vendim të gjykatës ose të ndonjë autoriteti tjetër kompetent.

9.2 Ekskluziviteti dhe ndalimi i dublimit të mjeteve mbrojtëse

Është rënë dakord që e drejta për të marrë dëmshpërblim sipas kësaj dispozite përjashton dhe nuk do të dublohet nga ndonjë e drejtë, mjet mbrojtës, pretendim ose mënyra të tjera mbrojtëse të mundshme për Blerësin në lidhje me shkeljen nga ana e Shitësit të deklarimeve dhe garancive të specifikuar në nenin 5.

9.3 Përjashtimet dhe kufizimet

a) Detyrimi për dëmshpërblim i Shitësit sipas kësaj kontrate do të hyjë në fuqi vetëm kur shuma totale e humbjeve, objekt i kërkesës për dëmshpërblim nga ana e Blerësit në tërësi e kalon shumën 1 000 000 (një milion) euro, me kusht që nëse ky limit kalohet, Shitësi do të jetë përgjegjës ose i detyruar të paguajë vetëm shumën mbi kufi.

b) Në asnjë rast shuma totale që duhet të paguhet nga Shitësi si dëmshpërblim në bazë të këtij neni nuk do të kalojë 30 (tridhjetë) % të çmimit të blerjes.

c) Shumës që duhet të paguhet nga Shitësi sipas kësaj dispozite në lidhje me një kërkesë për dëmshpërblim, do t'i zbritet: (i) çdo shume që Shoqëria ka marrë në bazë të çdo politike sigurimi, që është në fuqi në datën e kësaj kontrate ose nga çdo palë e tretë në lidhje me çështjen specifike, që është objekt i kërkesës për dëmshpërblim ndaj Shoqërisë; (ii) çdo përfitim nga taksat në favor të Blerësit ose të Shoqërisë si rezultat i ngjarjes që solli pagimin e dëmshpërblimit.

d) Shitësi do të ketë të drejtën e kompensimit ndaj çdo humbjeje, e cila është objekti i një pretendimi nga ana e Blerësit, të shumës së çdo aset apo kredie të rastësishme, që rrjedh ose varet nga rrethanat ose veprimet e ndodhura ose të ndërmarra përpara datës së fundit kontabël dhe që nuk janë pasqyruar në llogaritë.

e) Në asnjë rast Shitësi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit në lidhje me ndonjë shkelje të pretenduar të deklaratave dhe garancive, njoftimi i të cilave i është dhënë Shitësit pas 12 muajve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

9.4 E drejta e Shitësit në lidhje me humbjet

Blerësi bie dakord të njoftojë Shitësin për çdo fakt, që lidhet me të drejtat dhe detyrimet e detajuara të kësaj marrëveshjeje, që mund t'i shkaktojë Shoqërisë një humbje për t'u dëmshpërblyer, për të cilën Shitësi mund të konsiderohet përgjegjës menjëherë pas marrjes dijeni, dhe në çdo rast brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes dijeni, me kusht që në rast se afati i fundit për të depozituar një ankesë ose kundërshtim në lidhje me këtë humbje është më pak se 30 (tridhjetë) ditë, njoftimi duhet t'i jepet Shitësit sipas kësaj kontrate nga Blerësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data që ai ka marrë dijeni për këtë me njoftim me shkrim, ku të tregohen pretendimet që ai synon të bëjë në mënyrë të detajuar dhe të arsyeshme, së bashku me gjithë dokumentacionin që disponon, i cili mund të jetë i nevojshëm për të mundësuar Shitësin për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me humbjen që është objekti i kësaj kërkesë. Për qëllimin e kësaj dispozite, dijenia e Shoqërisë do të konsiderohet të jetë edhe dijenia e Blerësit.

Shitësi ka të drejtë të bëjë menaxhimin e rrethanave, të cilat janë shkak për ngritjen e pretendimeve nga ana e Blerësit dhe Blerësi bie dakord të sigurojë, në bazë të kërkesës së Shitësit, se Shoqëria: i) do të mbajë Shitësin të informuar rregullisht dhe menjëherë për çdo njoftim, komunikim ose informacion tjetër në çdo mënyrë të marrë nga Shoqëria në lidhje me një pretendim të tillë; ii) do të bashkëpunojë me Shitësin në lidhje me zhdëmtimet dhe veprimet përkatëse, duke i dhënë Shitësit mundësi të plota për t'i parë të gjitha shënimet, dokumentet, dosjet dhe të dhënat e lidhura me to, si dhe duke e siguruar mbështetjen e nevojshme nga punonjësit e saj; iii) do të respektojë çdo udhëzim të Shitësit në realizimin e procedimeve ligjore dhe/ose negociatave zgjidhëse dhe/ose iniciativave të tjera në lidhje me të.

Në qoftë se Shitësi nuk arrin t'i japë instruksionet menjëherë pas marrjes së njoftimit përkatës nga Blerësi, Blerësi pa shkelur sa më sipër, merr të gjitha hapat e arsyeshme, të cilat mund të kërkojnë për të zvogëluar shumën, për të cilën kërkohet dëmshpërblimi, si dhe mundëson Shoqërinë të ndërmarrë të gjitha këto hapa të arsyeshme, si dhe do ta njoftojë Shitësin plotësisht dhe menjëherë për këto iniciativa dhe hapa.

Marrja nga Blerësi ose Shoqëria e ndonjë iniciative në lidhje me këto pretendime pa marrë më parë pëlqimin me shkrim të Shitësit ose mospërmblidhja nga ana e Shoqërisë e dispozitave të mësipërme të këtij neni, bën që Shitësi të shkarkohet nga detyrimi për të dëmshpërblyer Blerësin në lidhje me pretendimin përkatës.

Shitësi do të jetë i detyruar të paguajë Blerësin ose Shoqërinë sipas këtij neni, vetëm nëse dhe kur humbja përkatëse është bërë e pagueshme.

9.5 Terma të veçantë që kanë të bëjnë me detyrimet ambientale

Nëse mund të jetë rasti, Shitësi bie dakord që Blerësin ose Shoqërinë ta mbrojë dhe zhdëmtojë nga çdo dëmtim që rrjedh nga shkelja e ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Mbi mbrojtjen e ambientit" dhe nga çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit, të cilat mund të jenë kryer nga Shoqëria përpara datës së mbylljes. Në këtë rast dëmshpërblimi nga ana e Shitësit do të rregullohet me kushtet që përmbahen në këtë pikë të marrëveshjes.

Asnjë shkelje e akteve ligjore dhe nënligjore referuar kësaj klauzole do t'i japë të drejtë Blerësit për t'u dëmshpërblyer veçse dhe deri kur kjo shkelje të ketë rezultuar në ndonjë dëmtim, mbasi është vendosur me vendim përfundimtar të gjykatës ose ndonjë autoriteti tjetër kompetent, dëm që është duke u paguar nga Shoqëria. Shitësi do të jetë i detyruar ta paguajë Blerësin ose Shoqërinë sipas kësaj klauzole vetëm në qoftë se dhe kur dëmtimet përkatëse janë bërë të pagueshme me vendim përfundimtar të gjykatës ose ndonjë autoriteti tjetër kompetent.

Për çfarë nuk është deklaruar në paragrafët e mësipërm, do të zbatohet neni 9.2 dhe neni 9.3, paragrafët (c), (d) dhe (e). Gjithashtu do të zbatohet neni 9.4 duke qenë i detyruar Blerësi të njoftojë Shitësin për ndonjë shkelje të akteve ligjore e nënligjore të referuara në paragrafin e parë, që u nënshtrohen termave dhe kushteve të parashikuara në nenin 9.4 paragrafi i parë.

Neni 10

Forca madhore

Mospërmblidhja e detyrimeve të marra përsipër sipas kësaj kontrate prej ndonjë palë, nuk do të konsiderohet shkelje ose mospërmblidhje e kësaj kontrate, në rast se kjo mospërmblidhje vjen si

pasojë e një force madhore, me kusht që pala e dëmtuar nga kjo ngjarje:

a) të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, kujdesin e duhur dhe masa alternative të arsyeshme, për të plotësuar kushtet dhe afatet e kësaj kontrate;

b) të ketë njoftuar palën tjetër sa më shpejt që të jetë e mundur për këtë ngjarje.

Çdo periudhë, brenda së cilës një palë, sipas kësaj kontrate, do të kryejë ndonjë veprim ose detyrë, do të zgjatet për një periudhë kohe të barabartë me periudhën e kohës, gjatë së cilës kjo palë nuk ishte në gjendje që të kryente këtë veprim për shkak të forcës madhore.

Neni 11 Përfundimi

Kjo kontratë mund të përfundohet vetëm për sa vijon:

a) me marrëveshjen reciproke me shkrim ndërmjet Shitësit dhe Blerësit në datën e dhënë në të;

b) nga Blerësi para mbylljes në qoftë se:

i) Shitësi nuk përmbush detyrimet e tij sipas nenit 8.4, me kusht që të jenë përmbushur kushtet e nenit 8.1 dhe 8.2 dhe Blerësi ka plotësuar detyrimet e tij sipas nenit 8.3;

c) nga Shitësi para mbylljes në qoftë se:

i) Blerësi prish ndonjë nga deklaratimet dhe garancitë e nenit 6;

(ii) Blerësi nuk përmbush detyrimet e tij sipas nenit 8.3, me kusht që të jenë përmbushur kushtet e nenit 8.1 dhe 8.2.

Neni 12 Ligji që do të zbatohet dhe juridiksioni

Kjo kontratë rregullohet nga e drejta angleze.

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me vlefshmërinë, efektivitetin, interpretimin, zbatimin e detyrueshëm dhe mbarimin e kësaj kontrate do të zgjidhet përfundimisht nga një trup prej tre arbitrash, sipas rregullave të pajtimit dhe arbitrit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Parisit.

Arbitrazhi do të zhvillohet në Paris dhe gjuha e procedimit të arbitrit do të jetë gjuha angleze.

Palët me anën e kësaj Kontrate heqin dorë nga zbatimi i ndonjë rregulli tjetër statutor dhe deklarojnë se njohin rregullat e pajtimit dhe arbitrit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Parisit.

Neni 13 Të ndryshme

13.1 Amendamentet

Asnjë amendament, modifikim, mbarim ose heqje dorë nga dispozitat e kësaj kontrate, nuk do të jenë të vlefshme në asnjë rast, në qoftë se nuk bëhen me shkrim dhe nuk nënshkruhen, nga ose në emër të secilës palë.

Mosushtrimi ose vonesa në ushtrimin e një të drejte ose të ndonjë mjeti mbrojtje, të parashikuar nga kjo kontratë ose me ligji, nuk përbën heqje dorë nga e drejta ose nga mjeti mbrojtjes, ose heqje dorë nga të drejta ose mënyra të tjera mbrojtje. Mosushtrimi i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte ose i një mjeti mbrojtës të parashikuar me këtë kontratë ose me ligj, nuk e pengon ushtrimin e mëtejshëm të së drejtës ose mjetit mbrojtës ose ushtrimin e një të drejte ose të një mjeti mbrojtës tjetër.

13.2 Ndashmëria

Në qoftë se ndonjë dispozitë ose detyrim sipas kësaj kontrate do të jetë i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në ndonjë juridiksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera, ose e këtyre dispozitave, ose detyrimeve në asnjë mënyrë nuk do të ndikohen ose dëmtohen në ndonjë juridiksion tjetër.

Palët do të përpiqen të zëvendësojnë ndonjë dispozitë të pazbatueshme ose të pavlefshme në masën më të madhe të mundshme për të arritur qëllimin e dispozitës së pazbatueshme ose të pavlefshme.

13.3 Kopjet

Kjo kontratë mund të nënshkruhet në një ose më shumë kopje dhe nga palë të ndryshme në kopje të veçanta, secila prej të cilave e nënshkruar dhe e dorëzuar në këtë mënyrë do të konsiderohet origjinale, por të gjitha këto kopje së bashku do të përbëjnë një instrument të njëjtë dhe të vetëm; faqet e firmosura mund të shkëputen nga kopjet e shumëfishta dhe të veçanta dhe mund t'i ngjiten një kopjeje të vetme në mënyrë që të gjitha faqet e firmosura t'i ngjiten fizikisht të njëjtit dokument.

Dokumenti është në versionin anglisht dhe atë shqip. Në rast konflikti ndërmjet dy versioneve, përparësi do të ketë versioni anglisht.

13.4 Njoftimet

Njoftimi ose komunikime të tjera sipas ose në lidhje me këtë kontratë (më poshtë “Njoftimi”) do të jetë:

- me shkrim;
- në gjuhën angleze;
- i dorëzuar ose i dërguar me postë rekomandë ose teleks, faks, palës që duhet ta marrë njoftimin në adresën e caktuar këtu më poshtë ose në një adresë tjetër të specifikuar nga kjo palë.

Me përjashtim të rasteve kur provohet se është marrë më shpejt, njoftimi konsiderohet i dhënë nëse:

- është dërguar me postë 10 (dhjetë) ditë-pune pas postimit të tij;
- është dërguar me telex, kur përgjigja përkatëse është marrë;
- është dërguar me faks kur konfirmimi i transmetimit është regjistruar nga faksi i dërguesit.

Adresat që u referohen janë:

Blerësi

- Emri i palës: _____
- Adresa: _____
- Nr. faksi: _____
- Dërguar në vëmendje të: _____

Shitësi

- Emri i palës: Ministria e Ekonomisë
- Adresa: Bulevardi Zhan d'Ark, Tiranë
- Nr. faksi: _____
- Dërguar në vëmendje të: _____

13.5 Kalimi i të drejtave

Blerësi nuk mund të japë dhe kalojë ndonjë të drejtë, sipas kësaj kontrate në tërësi ose në veçanti pa pasur më parë pëlqimin me shkrim të Shitësit, pëlqim i cili nuk mund të mos jepet pa arsye.

13.6 Kostot dhe taksat

Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë kontratë, secila palë do të paguajë shpenzimet e veta që lidhen me negociatat, përgatitjet, nënshkrimet dhe realizimin prej saj të kësaj kontrate dhe të secilit dokument të referuar në të.

13.7 Tërësia e marrëveshjes

Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis palëve në lidhje me objektin e kësaj kontrate.

* * * *

Tiranë, më 2005

SHITËSI

SH.T. Ministër i Ekonomisë

Anastas Angjeli

Për dhe në emër të Shitësit

VENDIM Nr.272, datë 28.4.2005

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE RRJETIT
RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, rrjetit rrugor kombëtar t’i shtohen dhe 30 km rrugë.
 2. Në lidhjen 1, “Rrjeti rrugor kombëtar”, që i bashkëlidhet vendimit, shtohet emërtimi: “Drejtorisë rajonale të mirëmbajtjes së rrugëve, Gjirokastrë, Ura e Kardhiqit-Fushë-Bardhë-Delvinë, 30 km rrugë interurbane, dytësore”.
 3. Në tabelën “Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale”, që i bashkëlidhet vendimit, të hiqet emërtimi “Ura e Kardhiqit-Fushë-Bardhë-Delvinë”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.279, datë 28.4.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.313, DATË 1.7.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ÇAKTIMIN E STRUKTURËS, TË NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE TË POLICISË SË BASHKISË DHE KOMUNËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen që i bashkëlidhet vendimit nr.313, datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave, në pikën 9 të kreut XXXIV, të bëhen këto ndryshime:

1. Numri maksimal i punonjësve të policisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës të bëhet 250 (dyqind e pesëdhjetë) veta.
 2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkive dhe komunave të bëhet, gjithsej, 1 084 (një mijë e tetëdhjetë e katër) veta.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.280, datë 21.4.2005

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË AKSIONARËVE TË BANKËS ITALO-SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.9313, datë 11.11.2004 “Për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës Italo-Shqiptare”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së aksionarëve të Bankës Italo-Shqiptare, për transferimin e së drejtës së pronësisë së aksioneve të kësaj Banke, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.281, datë 28.4.2005

PËR DHËNIEN NË ADMINISTRIM TË PÛRKOHSHËM ALBPETROL SHA-SË, PATOS, TË NJË SIPËRFAQEJE TOKE, TË NEVOJSHME PËR SHPIMIN DHE VËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PUSIT DELVINA-34

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqërisë anonime Albpetrol, Patos t’i jepet në administrim të përkohshëm, pa shpërblim, sipërfaqja prej 7000 m², në zonën gazmbajtëse Delvinë, në parcelat e kadastruara me nr.21 e nr.22, të emërtuara “Llakopin”, zonë pyjore shtetërore me koordinata X=4424100, Y=4425430, Z=410, në ekonominë pyjore, Dhrovjan.

2. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.282, datë 28.4.2005

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË SESIONIT TË 8-TË TË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT SHQIPTARO-TURK, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK, TREGTAR, INDUSTRIAL DHE TEKNIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të sesionit të 8-të të komisionit të përbashkët shqiptaro-turk, për

bashkëpunimin ekonomik, tregtar, industrial dhe teknik.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PROTOKOLL

I SESIONIT TË TETË TË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT SHQIPTARO-TURK MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK, TREGTAR, INDUSTRIAL DHE TEKNIK

Sesioni i tetë i komisionit të përbashkët shqiptaro-turk për bashkëpunimin ekonomik, tregtar, industrial dhe teknik (më tej Komisioni i Përbashkët), i krijuar në bazë të nenit 6 të “Marrëveshjes për bashkëpunimin ekonomik, tregtar, industrial dhe teknik” nënshkruar më 2 mars 1988 midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë, zhvilloi punimet në datat 27-28 janar 2005 në Ankara.

Delegacioni shqiptar u kryesua nga Shkëlqesia e Tij Agron Duka, Ministër i Bujqësisë dhe i Ushqimit të Republikës së Shqipërisë dhe delegacioni turk u kryesua nga Shkëlqesia e Saj Znj. Güldal Aksit, Ministre Shteti e Republikës së Turqisë.

Anëtarët e të dy delegacioneve janë të shënuar përkatësisht në anekset I dhe II të këtij protokoll.

Gjatë qëndrimit të tij në Ankara, Shkëlqesia e Tij Agron Duka, Ministër i Bujqësisë dhe i Ushqimit të Republikës së Shqipërisë zhvilloi bisedime me Shkëlqesinë e Tij Kürsad Tüzmen, Ministër Shteti, Shkëlqesinë e Tij Ali Coskun, Ministër i Industrisë dhe i Tregtisë dhe Shkëlqesinë e Tij Sami Güclü, Ministër i Bujqësisë dhe Çështjeve Rurale.

Sesioni i tetë i Komisionit të Përbashkët u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë dhe miqësore, e cila pasqyronte dëshirën për të gjetur rrugë dhe mjete praktike, të realizueshme dhe efektive për rritjen e bashkëpunimit, në linjë me potencialet e të dy vendeve.

Kryetarët e të dy delegacioneve paraqitën gjendjen ekonomike në vendet respektive dhe deklaruan se objektivat e përbashkëta të të dyja qeverive ishin zhvillimi i lidhjeve më të fuqishme ekonomiko-tregtare, si edhe nxitja e investimeve dhe tregtisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë. Kryetarët e delegacioneve theksuan, gjithashtu nevojën e përdorimit më të mirë të kapaciteteve tregtare, ekonomike dhe industriale të të dy vendeve.

Të dyja palët konstatuan me kënaqësi se sesioni i tetë i Komisionit të Përbashkët u zhvillua pak përpara vizitës në Shqipëri të Shkëlqesisë së Tij Recep Tayyip Erdogan, Kryeministër i Turqisë, dhe deklaruan se kjo vizitë do të kontribuonte më tej në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare ndërmjet dy vendeve.

Gjatë takimit u diskutuan çështje të ndryshme të interesit reciprok dhe rezultatet e këtyre diskutimeve janë përmbledhur si më poshtë vijon:

I. Marrëdhëniet tregtare

1. Marrëdhëniet tregtare dypalëshe dhe aktivitetet e nxitjes së tregtisë

Të dyja palët shqyrtuan shkëmbimet tregtare ndërmjet dy vendeve që nga sesioni i kaluar i Komisionit të Përbashkët, i mbajtur në maj të vitit 2002 në Tiranë.

Të dyja palët shprehën kënaqësinë për rritjen e kohëve të fundit të shënuar në volumin e tregtisë dypalëshe, i cili ka arritur dyfishin e shifrës së regjistruar në kohën e takimit të sesionit të kaluar dhe vendosën të bëjnë përpjekje të harmonizuara për të rritur dhe diversifikuar tregtinë dypalëshe mbi bazën e ekuilibrit dhe të përfitimit reciprok, si dhe për identifikimin e mallrave të reja tregtare.

Të dyja palët shprehën gatishmërinë e tyre për të mbështetur shkëmbimin e vizitave ndërmjet përfaqësuesve të sektorit publik dhe privat të të dy vendeve, si edhe pjesëmarrjen në panairë dhe ekspozita të organizuara në të dy vendet, të cilat do të kontribuonin në një shkallë të madhe në zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe ekonomike dhe tregtare.

Pala shqiptare, me qëllim rritjen e marrëdhënieve ekonomiko-tregtare ndërmjet dy vendeve, propozoi sa më poshtë vijon:

- Nënshkrimin e një protokoll bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Nxitjes së

Eksporteve dhe Qendrës Turke të Nxitjes së Eksporteve (IGEME);

- Asistencë turke për Entin Kombëtar të Zonave të Lira në Shqipëri, në veçanti lidhur me kurse trajnuese dhe seminare;

- Rritjen e kontakteve institucionale dhe informacionit tregtar ndërmjet dhomave të tregtisë/shoqatave të biznesit të të dy vendeve;

- Sigurimin e trajnimeve për zyrtarë shqiptarë lidhur me përvojën turke në aktivitetet e nxitjes së tregtisë;

- Vendosjen e kontakteve në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrjes së tregut ndërmjet institucioneve homologe respektive të të dy vendeve.

Të dyja palët, duke pasur parasysh rolin e luajtur nga Këshilli i Biznesit Shqiptaro-Turk në lehtësimin e vizitave dhe në përmirësimin e kontakteve ndërmjet qarqeve të biznesit të të dy vendeve, theksuan nevojën e rritjes së mëtejshme të aktiviteteve të Këshillit të Biznesit.

Të dyja palët ranë dakord për nevojën e dhënies së lehtësive të nevojshme tregtarëve dhe biznesmenëve lidhur me hyrjet në vendet përkatëse.

2. Marrëdhëniet bankare

Të dyja palët, duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit bankar në lehtësimin e shkëmbimeve tregtare ndërmjet dy vendeve, ranë dakord të nxisin kontakte më të ngushta në të gjitha drejtimet ndërmjet bankave të tyre tregtare, përfshirë hapjen e filialeve, krijimin e bankave të përbashkëta dhe të shërbimeve të korrespondencës.

Të dyja palët morën shënim se borxhi i vjetër i papaguar i Shqipërisë ndaj Turqisë është riskeduluar në periudhën 2000-2001 dhe se Ministria shqiptare e Financave shlyen rregullisht detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet përkatëse të riskedulimit ndërmjet Komitetit Qeveritar shqiptar të Borxhit të Jashtëm dhe Turk Eximbank, si edhe ndërmjet Komitetit Qeveritar shqiptar të Borxhit të Jashtëm dhe Bankës Qendrore të Turqisë.

3. Marrëveshja e tregtisë së lirë

Të dyja palët vlerësuan rezultatet e raundit të parë të negociatave, lidhur me marrëveshjen e tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë të mbajtur në prill të vitit 2003 dhe theksuan synimin për ta përfunduar këtë Marrëveshje sa më shpejt që të jetë e mundur.

4. Bashkëpunimi teknik

Të dyja palët theksuan rëndësinë e bashkëpunimit teknik të prirë nga Administrata turke e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (TICA) në përputhje me “Marrëveshjen e Bashkëpunimit” të nënshkruar ndërmjet autoriteteve përkatëse të të dy vendeve.

Të dyja palët konfirmuan se vëmendje e nevojshme duhet të kushtohet nga palët respektive, me qëllim që të mbështetet rritja e bashkëpunimi ekzistues në kuadrin e marrëveshjes në fjalë.

Pala shqiptare propozoi nënshkrimin e një protokollit ndërmjet Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja (ANIH) dhe Administratës turke të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (TICA) me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet dy palëve.

5. Standardizimi

Të dyja palët, duke pasur parasysh impaktin përshpejtues të bashkëpunimit në fushën e standardizimit lidhur me përmirësimin e marrëdhënieve tregtare, shprehën dëshirën për të forcuar marrëdhëniet ekzistuese ndërmjet Institutit shqiptar të Standardeve (DPS) dhe Institutit turk të Standardeve (TSE).

Lidhur me këtë, të dyja palët vendosën të bashkëpunojnë në fushat e poshtëshënuara:

- Vazhdimi i shkëmbimit të informacionit teknik dhe të dokumenteve;

- Mbështetja e njëri-tjetrit në forumet ndërkombëtare të tilla; si Organizata Ndërkombëtare e Standardeve (ISO), Komisioni Elektroteknik Ndërkombëtar (IEC) dhe forumet rajonale të tilla, si Komiteti European i Standardeve (CEN), Komiteti European i Standardeve Elektroteknike (CENELEC);

- Pjesëmarrja aktive në veprimtaritë e Shoqatës Ndërrajonale të Standardeve (IRSA).

II. Marrëdhëniet ekonomike

1. Energjia

Të dyja palët, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm të sektorit energjetik në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet dy vendeve, vendosën të shtojnë më tej bashkëpunimin në këtë fushë.

Pala turke i propozoi palës shqiptare që të përcaktonte një skedul shlyerje lidhur me borxhin

që rrjedh nga eksporti i energjisë nga Turqia në Shqipëri në vitin 1990, si dhe i kërkoi palës shqiptare që të zhvillohej një takim lidhur me këtë çështje në kohën e përshtatshme më të afërt.

Pala turke deklaroi se Turqia do të ishte e kënaqur me pjesëmarrjen e Shqipërisë - e cila konsiderohet si një vend kërkues potencial dhe vend transit - me anë të kompanive të saj publike dhe private, në projektet e planifikuara në kuadrin e strategjisë së Turqisë lidhur me transportin e gazit natyral në Europë.

Të dyja palët shprehën kënaqësinë e tyre për pjesëmarrjen në studimet në vazhdim në kuadrin e Iniciativës të Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SECI), Forumit Rregullator Elektrik të Europës Juglindore (SEEERF) dhe Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BSEC), lidhur me krijimin e një tregu elektrik kompetitiv në Europën Juglindore dhe integrimin e tij në tregun e brendshëm elektrik të Bashkimit Europian, si edhe nënvizuan përfitimin nga bashkëpunimi në këtë proces.

Pala shqiptare ftoi investuesit dhe kompanitë turke që të marrin pjesë në projektet e sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri.

Pala turke shprehu gatishmërinë e Punimeve Hidraulike Shtetërore Turke (DST) për të shkëmbyer informacion dhe përvojë me institucionin homolog shqiptar, lidhur me përmirësimin e burimeve të tokës dhe të ujit.

2. Industria

Të dyja palët theksuan se industria është një nga fushat më të rëndësishme të bashkëpunimit dhe ranë dakord që të nxisin organizatat dhe institucionet e tyre respektive për të rritur bashkëpunimin me interes të përbashkët.

Pala shqiptare propozoi rritjen e bashkëpunimit ekzistues në gjeologji, miniera, industrinë përpunuese minerare, veçanërisht në bakër, kromite, industrinë mekanike dhe të çelikut.

3. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME)

Të dyja palët, duke iu referuar *rout vital* të SME-ve në ekonomitë e tyre respektive, ranë dakord që të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme me qëllim përmirësimin e kontakteve ndërmjet SME-ve të të dy vendeve, mbështetjen e iniciativave të tyre dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet organizatave respektive me synim nxitjen e mëtejshme të aktiviteteve ekonomike dhe tregtare.

Pala shqiptare sugjeroi rinovimin e protokollit të bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë shqiptare të SME-ve dhe Organizatës turke të Zhvillimit të Industrisë së Vogël dhe të Mesme (KOSGEB).

Pala turke shprehu gatishmërinë e saj për dhënien e përvojës së KOSGEB tek Agjencia shqiptare e SME-ve.

4. Bujqësia

Të dyja palët shprehën dëshirën për të zgjeruar më tej bashkëpunimin në sektorin e bujqësisë dhe ranë dakord që të nxisin autoritetet përkatëse për të marrë masat e nevojshme në këtë drejtim.

Pala shqiptare shprehu gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar në fushën e kultivimit të perimeve dhe kontrollit të cilësisë dhe standardeve të ushqimeve si edhe kërkoi shkëmbimin e informacionit lidhur me nxitjen e investimeve dhe transferimit të teknologjisë turke.

Gjithashtu, pala shqiptare shprehu interes lidhur me:

- Nënshkrimin e një marrëveshje-fitosanitare;
- Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve veterinarë të vendeve;
- Shkëmbimin e informacionit mbi legjislacionin në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit;
- Mbështetjen dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve respektive kërkimore-shkencore;

- Trajnimin e specialistëve të institucioneve kërkimore dhe të biznesit agroushqimor;
- Zgjatjen e projektit të bashkëpunimit lidhur me përmirësimin racor të lopëve Xhersej.

Pala turke sugjeroi bashkëpunim në fushat e poshtëshënuara:

- Organizimin e programeve trajnuese në fushat e diagnostifikimit, kontrollit dhe eliminimit të sëmundjeve të ndryshme të kafshëve në kuadrin e luftës kundër sëmundjeve të tilla, si edhe në fushat e epidemiologjisë dhe luftës së integruar dhe biologjike kundër sëmundjeve të bimëve;
- Shkëmbimin e informacionit teknik dhe të specialistëve;
- Shqyrtimin e mundësive të investimeve të përbashkëta në fushën e peshkimit;
- Bashkëpunimin teknik lidhur me përmirësimin e bujqësisë.

5. Gjeologjia dhe minierat

Të dyja palët nënvizuan rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve gjeologjike respektive. Ky bashkëpunim mund të përfshijë, *inter alia*, zbatimin e projekteve me interes

të përbashkët, shkëmbimin e përvojave, informacioneve dhe publikimeve, aspektet e rivlerësimit të tipeve të ndryshme të resurseve, problemet e metodikës së kërkimit të vendburimeve të kromit, korelacionet gjeologo-tektonike midis Albanideve dhe Taurideve, magmatizmin ofiolitik dhe metalogjenisë së tij, menaxhimin e territorit, hapësirat bregdetare, përpunimin e informacionit gjeologjik, organizimin e simpoziumeve të përbashkëta etj.

Pala turke shprehu gatishmërinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Kërkimit dhe Shfrytëzimit të Mineraleve (MTA) për të filluar bashkëpunimin me institucionin e saj homolog shqiptar në fushat e mëposhtme:

- Zbatimin e perceptimeve të largëta (RS) dhe të Sistemeve Informative Gjeografike (GIS);
- Analizën e kombinuar me anë të transferimit të hartave gjeologjike ekzistuese në mjedisin dixhital;

- Shkëmbimin e specialistëve dhe të njohurive në fushën e depozitave të kromit.

Pala shqiptare shprehu interes lidhur me tërheqjen në Shqipëri të sipërmarrësve turq për të investuar në industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve.

Pala shqiptare nënvizoi nevojën e shkëmbimit të përvojës ndërmjet institucioneve tekniko-shkencore të të dy vendeve në fushën e nxjerrjes së mineraleve tradicionale dhe industriale.

Pala shqiptare, duke pasur parasysh potencialet e konsiderueshme minerare të Turqisë, pjesërisht të ngjashme me mineralet e Shqipërisë, paraqiti interes për të bashkëpunuar në realizimin e studimeve të përbashkëta të fizibilitetit për olivinitet, dolomitet, gurët dekorativë dhe minerale të tjera.

6. Transporti

Të dyja palët, duke pasur parasysh rëndësinë e transportit në lehtësimin dhe në rritjen e tregtisë dypalëshe ndërmjet dy vendeve, deklaruan se mënjanimi i vështirësive me të cilat përballen transportuesit ishte tepër i rëndësishëm për të zgjeruar më tej marrëdhëniet tregtare.

Të dyja palët shprehën kënaqësinë që Komiteti i Përbashkët shqiptaro-turk mbi Transportin Rrugor do të zhvillojë punimet gjatë vitit 2005 në Tiranë dhe deklaruan vendosmërinë e tyre për të bërë çdo përpjekje të mundshme për të zgjidhur ndonjë vështirësi gjatë mbledhjes në fjalë.

Të dyja palët përsëritën rëndësinë e realizimit të Korridorit të Transportit Paneuropian.

Të dyja palët nënvizuan rëndësinë e transportit detar në forcimin dhe nxitjen e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve dhe ranë dakord që të shqyrtojnë studimin e përfundimit sa më shpejt që të jetë e mundur të marrëveshjes së re për transportin detar, e cila do të zëvendësojë marrëveshjen ekzistuese të vitit 1987.

Pala shqiptare parashtroi kërkesën për marrje asistence në përgatitjen e kuadrit ligjor për zonat e lira portuale, marinat detare dhe portet e jahteve.

Të dyja palët konstatuan me kënaqësi frekuencën e dendur të fluturimeve të dy shoqërive ajrore respektive, Albanian Airlines dhe Turkish Airlines.

Pala shqiptare informoi palën turke se Marrëveshja mbi transportin ajror ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë ishte ratifikuar nga Parlamentit shqiptar në shtator 2004.

Të dyja palët vendosën të inkurajojnë qarqet respektive të biznesit të transportit detar për të vendosur kontakte me të afërta me qëllim shqyrtimin e mundësive të bashkëpunimit në këtë fushë.

Pala turke shprehu gatishmërinë e Hekurudhave Shtetërore Turke (TCDD) për të bashkëpunuar në fushën e mirëmbajtjes, riparimit dhe prodhimit të mjeteve hekurudhore.

7. Shërbimet postare dhe telekomunikacioni

Pala turke, duke iu referuar sesionit të kaluar të Komisionit të Përbashkët të mbajtur në vitin 2002 në Tiranë, përsëriti gatishmërinë e autoritetit turk të telekomunikacionit për të bashkëpunuar me institucionin e saj homolog shqiptar lidhur me nënshkrimin e një protokolli bashkëpunimi me Entin Rregullues shqiptar të Telekomunikacionit, të bazuar mbi parimet e shkëmbimit të përvojës dhe njohurive mbi çështjet rregulluese të telekomunikacionit.

Të dyja palët deklaruan interesin për të rritur bashkëpunimin në fushat e shërbimeve postare, sistemeve tokësore dhe satelitore, si edhe për të shkëmbyer informacion dhe përvojë lidhur me përdorimin efikas të spektrit të frekuencës dhe monitorimit të spektrit.

8. Financat

Tatimet

Pala shqiptare njohu progresin e arritur që nga sesioni i kaluar në fushën e tatimeve dhe

propozoi forcimin e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet administratave tatimore përkatëse me qëllim shkëmbimin e përvojës dhe të informacionit në fushën e politikave tatimore dhe të administrimit të tatimeve.

Pala turke mori shënim këtë njoftim me qëllim përcjelljen e tij për tek autoritetet përkatëse turke.

Doganat

Të dyja palët ranë dakord për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit në fushën e doganave nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe aktiviteteve trajnuese.

9. Turizmi

Të dyja palët theksuan vendosmërinë e tyre për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekzistues në fushën e turizmit ndërmjet dy vendeve në kuadrin e marrëveshjes të bashkëpunimit në turizëm, nënshkruar më 11 nëntor 1992 në Ankara dhe përsëritën vendimin për mbajtjen e sesionit të 3-të të Komisionit të Përbashkët shqiptaro—turk në një datë e cila do të përcaktohet në rrugë diplomatike.

Pala shqiptare shprehu interes për bashkëpunimin në nivel institucional në aspektet e mëposhtme:

- Marrje asistence nga pala turke për hartimin e strategjisë afatgjatë të zhvillimit të turizmit, funksionimin e zyrave rajonale të turizmit, si edhe asistencë mbi legjislacionin e turizmit, veçanërisht të legjislacionit për marinat turistike;

- Shqyrtimi i mundësisë së marrjes nga pala turke të specializimeve afatshkurtra dhe afatmesme në fushën e turizmit për zyrat rajonale (përfaqësimit) të turizmit, rezortëve turistike, agjencive turistike, të udhëtimit dhe tour-operatorëve;

- Transferim i përvojës turke mbi harmonizimin ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të turizmit;

- Bashkëpunim në fushën e kërkimit dhe të statistikave.

10. Zhvillimi urban

Të dyja palët ranë dakord për shkëmbim informacioni dhe përvoja ndërmjet institucioneve homologe përkatëse në fushën e planifikimit dhe kontrollit të territorit, si edhe në fushën e hartimit të akteve legjislative për menaxhimin e tokës urbane.

Pala shqiptare parashtroi kërkesën për asistencë nga pala turke në fushën e trajtimit të zhvillimit urban në harmoni me mjedisin.

11. Mjedi

Pala shqiptare paraqiti interes për marrjen e asistencës turke lidhur me përmirësimin e gjendjes së kullotave, çështjet e erozionit, trajnimin e stafit të institucioneve pyjore, qendrat integruese për përfitim të lëndës drusore, parqet kombëtare dhe zonat ligatinore.

Pala turke i mori shënim këto propozime dhe u zotua që t'i përcillte ato për tek autoritetet përkatëse.

12. Shëndetësia

Të dyja palët, duke marrë në konsideratë bashkëpunimin në vijim e sipër të bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë dhe të shkencave mjekësore të nënshkruar në vitin 1999, ndërmjet dy vendeve, u rekomanduan autoriteteve të tyre përkatëse të zhvillojnë më tej bashkëpunimin në këtë fushë.

Në këtë kontekst të dyja palët vendosën të vazhdojnë bashkëpunimin në fushën e farmaceutikës, shëndetit të nënës dhe të fëmijës dhe të shëndetit riprodhues.

Të dyja palët vendosën që të mbajnë sesionin e nëntë të Komisionit të Përbashkët shqiptaro-turk për bashkëpunimin ekonomik, tregtar, industrial dhe teknik në Tiranë, në një datë e cila do të përcaktohet në rrugë diplomatike.

Bërë dhe nënshkruar më 28 janar 2005 në Ankara, në dy ekzemplarë në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË
E REPUBLIKËS SË TURQISË

VENDIM
Nr.283, datë 28.4.2005

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN ME KONCESION TË OBJEKTIT
“SHËRBIMI I LAVANDERISË DHE I PASTRIMIT TË BRENDSHËM NË QENDRËN
SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”, TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR
OBSTETRIK-GJINEKOLOGJIK NR.1 E NR.2, TIRANË, DHE NË SPITALIN
UNIVERSITAR TË SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 pika 11, e 5 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për dhënie me koncesion, si propozim i kërkuar, të objektit “Shërbimi i lavanderisë dhe i pastrimit të brendshëm në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik nr.1 e nr.2, Tiranë dhe Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive, Tiranë”.

2. Koncesioni të jetë i formës “BOT” (ndërtim-shfrytëzim-transferim), për një periudhë 5-vjeçare.

3. Ministria e Shëndetësisë është organi shtetëror i autorizuar për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion.

4. Organi shtetëror i autorizuar të ngrejë grupin e punës, për shqyrtimin e ofertave të paraqitura, sipas kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- Çmimi për njësi i shërbimit, jo më pak se 50 pikë;
- Vlera e investimit, 20 pikë;
- Cilësia e investitorit dhe përvoja në këtë veprimtari, 20 pikë;
- Plani i biznesit dhe cilësia teknike e propozimit, 10 pikë.

5. Procedurat e shqyrtimit dhe të vlerësimit të ofertave të përfundojnë brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM

Nr.285, datë 28.4.2005

PËR LEJIMIN E DALJES JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR QËLLIME RESTAURIMI, TË PIKTURËS “MOTRA TONE”, OBJEKT ME VLERA UNIKALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në Paris, Francë, të pikturës “Motra Tone”, objekt me vlera unike të trashëgimisë kulturore kombëtare.
2. Dalja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr.2, datë 18.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e lëvizjes së objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.
3. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr.975, datë 24.12.2004, ka vendosur të shpallë të vdekur shtetasin Cuman Vrako, i datëlindjes 5.7.1926, lindur dhe banues në Zhulat.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 18.5.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë